



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT

VENDIM

Nr. _____, datë ____/____/2014

“PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT

“PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7905, DATË 21.03.1995,
‘KODI I PROCEDURËS PENALE’, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 81, pika 1, dhe nenit 100, të Kushtetutës, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, ‘Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

MINISTRI I DREJTËSISË

NASIP NAÇO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKT

L I G J

Nr. ____ / 2014

“PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7905, DATË 21.03.1995,
‘KODI I PROCEDURËS PENALE’, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 2, shkronja “d”, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si vijon:

“Neni 1

Qëllimet e legjislacionit procedural penal

1. Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të personave.

V. I: 2. Normat procedurale penale garantojnë të drejtat e personave të dëmtuar nga vepra penale dhe mbrojtjen e tyre nga ridëmtimi.

V. II: 2. Normat procedurale penale garantojnë të drejtat e viktimave nga vepra penale dhe mbrojtjen e tyre nga ridëmtimi.

3. Normat procedurale penale ndihmojnë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare të ratifikuara.”

Neni 2

Neni 2 ndryshohet si vijon:

**“Neni 2
Fusha e veprimit të Kodit të Procedurës Penale**

1. Dispozitat procedurale caktojnë rregullat për mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale, të hetimit dhe gjykitimit të veprave penale, si dhe të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Këto rregulla janë të detyrueshme për subjektet e procedimit penal, personat juridikë dhe shtetasit.”

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si vijon:

**“Neni 3
Pavarësia e gjykatës**

1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve.
2. Gjykata jep vendim në bazë të provave që merren në seancë gjyqësore.”

Neni 4

Neni 4 ndryshohet si vijon:

**“Neni 4
Prezumimi i pafajësisë**

1. Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në gjykimin penal fajësia duhet të provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

2. Çdo dyshim për ekzistencën e faktit që përbën vepër penale apo nga i cili varet zbatimi i një dispozite të ligjit penal, çmohet në favor të të pandehurit.

3. Organet shtetërore, media, shoqatat dhe nëpunësit publikë detyrohen të respektojnë parimin e prezumimit të pafajësisë dhe të mos e shkelin atë nëpërmjet deklaratave publike që lidhen me të akuzuarin apo me procedimin kundër tij.”

Neni 5

Neni 5 ndryshohet si vijon:

**“Neni 5
Ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës**

1. Përdorimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtëruës, forcës, kërcënimeve, shtrëngimit, mashtrimit, procedurave mjekësore dhe metodave të tjera që ndikojnë mbi vullnetin e lirë të të pandehurit ose pjesëmarrësve të tjerë në procedim ose i shtrëngojnë ata të bëjnë pohime, të japin deklaratata ose dëshmi apo të kryejnë veprime të tjera është i ndaluar.”

Neni 6

Neni 6, ndryshohet si vijon:

**“Neni 6
E drejta e mbrojtjes**

1. I pandehuri ka të drejtë të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij.

2. I pandehuri ka të drejtë të mbrohet vetë ose me ndihmën e mbrojtësit të zgjedhur prej tij. Kur i pandehuri nuk ka mundësi financiare të zgjedhë një mbrojtës, atij i sigurohet mbrojtja falas nga shteti.”

Neni 7

Neni 7, ndryshohet si vijon:

**“Neni 7
Ne bis in idem**

1. Askush nuk mund të ndiqet penalisht dhe as të gjykohet përsëri për një veprë penale, për të cilën është dënuar ose deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë apo për të cilën është vendosur pushimi i çështjes me vendim gjyqësor të formës së prerë.

2. Nga ky rregull bëjnë përjashtim rastet kur një gjykatë më e lartë ka urdhëruar rigjykimin e çështjes, në përputhje me rregullat e parashikuara nga ky Kod.

Neni 8

Neni 8, ndryshohet si vijon:

**“Neni 8
Përdorimi i gjuhës shqipe**

1. Në të gjithë fazat e procedimit përdoret gjuha shqipe.

2. I pandehuri, dëshmitarët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedim kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre ose një gjuhë që njohin dhe të flasin e të marrin dijeni për provat e aktet, si dhe për zhvillimin e procedimit, nëpërmjet një përkthyesi.

3. Shpenzimet e përkthimit paguhen nga shteti.

Neni 9

Pas nenit 8, shtohet neni 8/a, b, c, ç, d, si vijon:

Varianti I

**“Neni 8/a
Të drejtat e të dëmtuarit nga vepra penale**

1. Organet publike sigurohen që të dëmtuarit nga vepra penale trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe mbrohen nga ridëmtimi nga vepra penale gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara nga ky Kod”.

Varianti II

**“Neni 8/a
Të drejtat e të dëmtuarit nga vepra penale**

1. Organet publike sigurohen që viktimat nga vepra penale trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe mbrohen nga ridëmtimi nga vepra penale gjatë ushtrimit të të drejtave të parashikuara nga ky Kod”.

Neni 8/b **Njohja me të drejtat**

1. Gjykata, prokurori dhe policia gjyqësore detyrohen të informojnë të pandehurin ose pjesëmarrës të tjerë në procedim për të të drejtat që ata kanë, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi.

2. Kur i pandehuri ose një pjesëmarrës tjetër në procedim nuk kryen një veprim apo nuk ushtron një të drejtë, për shkak të mosnjohjes së ligjit, gjykata, prokurori ose policia gjyqësore duhet ta këshillojnë për pasojat e moskryerjes.

Neni 8/c **Kufizimet e lirisë së personit dhe të drejtat e tij**

1. Para dhënies së një vendimi gjyqësor të formës së prerë për dënimin e tij, liria dhe të drejtat e personit mund të kufizohen vetëm për aq sa është e nevojshme për të realizuar qëllimet e procedimit kundër tij, në kushtet dhe kriteret e parashikuara në këtë Kod.

2. Personi, të cilit i është hequr liria, ka të drejtë të njoftohet menjëherë në gjuhën që ai kupton për shkaqet e kësaj mase dhe për akuzën që i bëhet. Ai duhet të njoftohet se nuk asnjë detyrim të bëjë asnjë deklaratë dhe ka të drejtë të komunikojë menjëherë me avokatin e zgjedhur, si edhe ka të drejtë t’i caktohet një avokat falas nëse nuk ka mundësi financiare të zgjedhë një avokat.”.

Neni 8/ç **Gjykimi brenda një kohe të arsyeshme**

1. Prokurori duhet ta përfundojë hetimin dhe sjellë të pandehurin para gjykatës sa më shpejt të jetë e mundur në rrethanat e çështjes konkrete.

2. Gjykata duhet të përfundojë gjykimin pa vonesë dhe të parandalojë çdo veprim të palëve që synon të vonojë gjykimin. Parimi i gjykimit brenda një kohe të arsyeshme zbatohet vecanërisht kur i pandehuri është mbajtur në arrest gjatë gjykimimit.

Neni 8/d **Liria e provës**

1. Provat mblidhen dhe shqyrtohen në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë Kod.

2. Barra e provës për të vërtetuar fajësinë në procesin penal i takon prokurorit.

3. Palët mund t’i provojnë faktet me çdo lloj prove, mjafton që prova të vlejë për t’i provuar këto fakte dhe të mos çënojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara nga Kushtetuta.

4. Gjykata i merr provat me kërkesë të palëve. Kur provat e marra në gjykim me kërkesë të palëve bien në kundërshtim me njera-tjetrën ose janë të paqarta dhe gjykata çmon se është e nevojshme për sqarimin e fakteve, ajo mund t’i udhërojë palët të sjellin

prova të reja. Përfundimisht, gjykata mund të marrë prova me iniciativën e vet, në kushtet e përcaktuara nga fjalia e dytë e këtij paragrafi.

Neni 10

Neni 9 ndryshohet si vijon:

Varianti I

“Neni 9 Rivendosja e të drejtave dhe kompensimi

1. Personave që procedohen në kundërshtim me ligjin ose dënohen pa të drejtë u kthehen të drejtat dhe kompensohen për dëmin e pësuar.”

Varianti II

“Neni 9 Rivendosja e të drejtave dhe kompensimi

1. Personat që procedohen në kundërshtim me ligjin ose dënohen pa të drejtë, konsiderohen viktimat në kuptim të këtij kodi dhe u kthehen të drejtat dhe kompensohen për dëmin e pësuar.”

Neni 11

Pas nenit 9 shtohet neni 9/a si vijon:

Neni 9/a Detyrimi për ndihmë

1. Organet shtetërore dhe entet publike janë të detyruara t’i japin policisë gjyqësore, prokurorit, gjykatës, si edhe të pandehurit e mbrojtësit të tij ndihmën e kërkuar gjatë mbledhjes së provave për t’u përdorur në një proces penal.”

Neni 12

Varianti I:

Në nenin 13 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a- Paragrafi i dytë, i tretë dhe i katërt ndryshohen si vijon:

“2. Në gjykatat e rretheve gjyqësore dhe gjykatat për krimet e rënda gjykohen nga një gjyqtar:

a) kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake;

b) kërkesat që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale;

c) kërkesat që lidhen me marrëdhënie juridiksionale me autoritetet e huaja.

3. Gjykatat e rretheve gjyqësore gjykojnë me një gjyqtar veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më shumë se 7 vjet në maksimum. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

4. Gjykatat për krimet e rënda gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë.”

b- Pas paragrafit të katërt, shtohet paragrafi i pestë, me këtë përmbajtje:

“5. Gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore.”

Varianti II:

Neni 13, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Neni 13 Gjykatat penale të shkallës së parë dhe përbërja e tyre

1. Veprat penale gjykohen në shkallë të parë nga gjykatat e rretheve gjyqësore dhe gjykatat për krimet e rënda, sipas rregullave dhe përgjegjësive të caktuara në këtë Kod.

2. Në gjykatat e rretheve gjyqësore dhe gjykatat për krimet e rënda gjykohen nga një gjyqtar:

- a) kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake;
- b) kërkesat që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale;
- c) kërkesat që lidhen me marrëdhënie juridiksionale me autoritetet e huaja.

3. Gjykatat e rretheve gjyqësore gjykojnë me një gjyqtar veprat penale, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më shumë se 7 vjet në maksimum. Veprat e tjera penale gjykohen me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.

4. Gjykatat për krimet e rënda gjykojnë me trup gjykues të përbërë nga pesë gjyqtarë, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë.

5. Gjykimi i të miturve bëhet nga seksionet përkatëse, të krijuara në gjykatat e rretheve gjyqësore.”

Neni 13

Neni 14/a, ndryshohet si vijon:

“Neni 14/a Gjykata e Lartë dhe përbërja e saj

1. Gjykata e Lartë shqyrton:

- a) me koleg të përbërë nga tre gjyqtarë pranueshmërinë e rekurseve dhe kërkesat e parashikuara nga paragrafi 2 i nenit 13;
- b) me koleg të përbërë nga pesë gjyqtarë çështjet e gjykuara nga gjykatat e apelit;
- c) me kolege të bashkuara çështjet që lidhen me unifikimin e praktikës gjyqësore.”

Neni 14

Paragrafi i dytë dhe i tretë të nenit 15, ndryshohen si vijon:

“2. Nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka shqyrtuar kërkesat e palëve gjatë hetimit paraprak për të njëjtën çështje.

3. Nuk mund të ushtrojë në të njëjtin procedim detyrën e gjyqtarit ai që ka qenë prokuror ose që ka kryer veprime të policisë gjyqësore ose që ka qenë mbrojtës, përfaqësues i një pale ose dëshmitar, ekspert ose që ka paraqitur një kallëzim, ankim ose kërkesë për procedim.”

Neni 15

Neni 17, ndryshohet si vijon:

“Neni 17 Papajtueshmëri të tjera

1. Gjyqtari nuk mund të marrë pjesë në gjykimin e çështjes konkrete:
- a) kur ka interes në procedim ose kur një nga palët private ose një mbrojtës është debitor a kreditor i tij, i bashkëshortit ose i fëmijëve të tij;
 - b) kur është kujdestar, përfaqësues apo punëdhënës i të pandehurit ose i njërit nga palët private ose kur mbrojtësi a përfaqësuesi i njërit prej këtyre palëve është gjini e afërt e tij ose e bashkëshortit të tij;
 - c) kur ka dhënë këshilla ose kur ka shfaqur mendim mbi objektin e procedimit;
 - ç) kur ekzistojnë mosmarrëveshje ndërmjet tij, bashkëshortit ose ndonjë të afërmi të tij me të pandehurin ose njërit prej palëve private;
 - d) kur ndonjë prej të afërmit të tij ose të bashkëshortit është cenuar ose dëmtuar nga vepra penale;
 - dh) kur një i afërm i tij ose i bashkëshortit kryen ose ka kryer funksionet e prokurorit në të njëjtin procedim;
 - e) kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.”

Neni 16

Pas nenit 17, shtohet neni 17/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 17/a Heqja dorë e gjyqtarit

1. Gjyqtari heq dorë nga gjykimi i çështjes nëse ndodhet në një nga kushtet e papajtueshmërisë të parashikuara nga nenet 15, 16 dhe 17 të këtij Kodi.
 2. Deklarimi i heqjes dorë i paraqitet kryetarit të gjykatës përkatëse, i cili e pranon ose e rrëzon atë me vendim të arsyetuar. ”.
- Për deklarin e heqjes dorë të kryetarit të gjykatës së shkallës së parë vendos kryetari i gjykatës së apelit dhe për kërkesën e këtij të fundit vendos kryetari i Gjykatës së Lartë.

Neni 17

Në nenin 18, bëhen këto shtesa:

- a- Në gërmën “a”, të pikës 1, të nenit 18, pas togfjalëshit “...dhe 17”, shtohet togfjalëshi “të këtij Kodi.”
- b- Në pikën 2, të nenit 18, togfjalëshi “...kërkesën e përjashtimit”, zëvendësohet me togfjalëshin “...kërkesën për përjashtimin e tij.”.

Neni 18

Neni 19 ndryshohet si vijon:

“Neni 19 Afatet dhe format e kërimit të përjashtimit

1. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit mund të bëhet nga prokurori, i dëmtuari akuzues, i pandehuri ose mbrojtësi i tij dhe palët private.
2. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit bëhet në seancë përgatitore ose në seancën e parë gjyqësore, menjëherë pas legjitimitit të palëve.

3. Kur shkak i përjashtimit lind ose zbulohet pas momentit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, kërkesa duhet të bëhet brenda tre ditëve nga marrja dijoni për shkakun e papajtueshmërisë.

4. Kërkesa për përjashtim bëhet me shkrim dhe tregon shkaqet, për të cilat kërkohet përjashtimi, si edhe provat përkatëse.

5. Kërkesa dhe provat i dorëzohen gjykatës që shqyrton çështjen ose sekretarisë së gjykatës. Në rastin e dytë, një kopje e kërkesës i jepet gjyqtarit për të cilin kërkohet përjashtimi.”

Neni 20

Neni 21 ndryshohet si vijon:

“Neni 21

Kompetencat për të vendosur përjashtimin

1. Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit shqyrtohet nga një gjyqtar tjetër i së njëjtës gjykatë. Shqyrtimi kryhet *in camera* dhe bazohet mbi kërkesën dhe provat e paraqitura.

2. Nuk lejohen kërkesat për përjashtimin e gjyqtarit të caktuar për të vendosur mbi përjashtimin.”

Neni 21

Neni 22 ndryshohet si vijon:

“Neni 22

Vendimi mbi kërkesën për përjashtim

1. Gjyqtari i caktuar për të shqyrtuar kërkesën për përjashtim merr vendim për mospranimin, rrëzimin ose pranimin e saj brenda ditës së nesërme të punës.

2. Gjyqtari vendos mospranimin e kërkesës në rastet kur:

- a) kërkesa është bërë nga persona që nuk e kanë këtë të drejtë sipas nenit 19 të këtij Kodi;
- b) kërkesa është paraqitur jashtë afateve të parashikuara në nenin 19 të këtij Kodi;
- c) kërkesa është e paarsyetuar;
- ç) kërkesa është paraqitur më parë për të njëjtat shkaqe dhe është vendosur mospranimi ose rrëzimi i saj;
- d) kërkesa haptazi synon zvarritjen e gjykimit;
- dh) gjyqtari ka deklaruar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes dhe kërkesa e tij është pranuar.

3. Gjyqtari vendos rrëzimin e kërkesës, nëse nuk provohet ekzistenca e shkakut të përjashtimit ose nëse shkak i pretenduar nuk parashikohet nga ligji si i tillë.

4. Vendimi për rrëzimin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin përfundimtar.”

Neni 22

Neni 23 ndryshohet si vijon:

“Neni 23

Disponimet kur pranohet deklarimi i heqjes dorë dhe kërkesa e përjashtimit

1. Kur deklarimi i heqjes dorë ose kërkesa për përjashtim pranohen, gjyqtari nuk mund të kryejë asnjë veprim procedural me çështjen.

2. Dispozitat për heqjen dorë dhe përjashtimin e gjyqtarit zbatohen edhe për sekretarin e seancës dhe personat e ngarkuar me regjistrimin e seancave gjyqësore ose transkriptimin e këtyre regjistrimeve. Për heqjen dorë ose përjashtimin e tyre vendos gjykata që shqyrton çështjen.”

Neni 23

Pika 1 dhe 2, e nenit 24, ndryshohen si vijon:

“1. Prokurori bën hetime, kontrollon hetimet paraprake, ushtron ndjekjen penale, ngre akuzë në gjykatë dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, në përputhje me rregullat e caktuara në këtë Kod.

2. Prokurori ka të drejtë të mos regjistrojë ose të pushojë procedimin penal në rastet e parashikuara në këtë Kod.”

Neni 24

Pas nenit 34, shtohen nenet 34/a, 34/b dhe 34/c me këtë përmbajtje:

“Neni 34/a

Të drejtat e të pandehurit

1. I pandehuri ka të drejtë:

- a) të njoftohet në një kohë sa më të shkurtër, me detaje dhe në gjuhën që kupton për akuzat kundër tij dhe se gjithçka që ai deklaron mund të përdoret si provë kundër tij;
- b) të mos bëjë deklarime, të mos u përgjigjet pyetjeve të caktuara, të prezantojë lirisht mbrojtjen e tij, të pranojë ose të mos pranojë fajësinë e tij;
- c) të mbrohet vetë ose me ndihmën e një mbrojtësi, në përputhje me dispozitat e këtij Kodi;
- ç) të dërgohet në gjykatë në kohën më të shkurtër të mundshme dhe të gjykohet me drejtësi e paanësi në një kohë të arsyeshme;
- d) të ketë kohën dhe lehtësitë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen;
- dh) të lexojë dhe të marrë kopje të akteve të fashikullit të prokurorit;
- e) të mbledhë prova që i shërbejnë mbrojtjes së vet;
- ë) të deklarojë qëndrimin e tij në lidhje me faktet dhe provat kundër tij, të prezantojë fakte dhe prova në favor të tij, të pyesë dëshmitarët e akuzës dhe të kërkojë që dëshmitarët e mbrojtjes të pyeten në prani të tij;
- f) të kryejë veprime të tjera të parashikuara nga ky Kod.

2. Përpara se të marrë deklaratimet ose dëshminë e tij, autoriteti procedues informon të pandehurin për të drejtat e parashikuara nga pikat b) dhe c) të paragrafit të parë të këtij neni.

3. Nëse i pandehuri heq dorë nga të drejtat e parashikuara nga pikat b) dhe c) të paragrafit të parë të këtij neni, heqja dorë shënohet në mënyrë të shprehur në procesverbalin përkatës.

Neni 34/b

Të drejtat e të pandehurit të arrestuar

Përveç të drejtave të parashikuara nga pikat b) dhe c) të paragrafit të parë të nenit 45 të këtij Kodi, i pandehuri i arrestuar ka të drejtë:

- a) të njoftohet menjëherë dhe në gjuhën që kupton për arsyet e arrestimit të tij;
- b) të zhvillojë, përpara dhënies së deklarimeve të para, një takim konfidencial me mbrojtësin e tij;
- c) të kërkojë që një anëtar i familjes ose një person tjetër i afërt të njoftohet pa vonesë për arrestimin e tij. Në rast se i pandehuri i arrestuar është shtetas i huaj, ai ka të drejtë të kërkojë njoftimin e përfaqësisë konsullore ose diplomatike të vendit të tij dhe, në rast se është person pa shtetësi apo refugjat, ai ka të drejtë të kërkojë njoftimin e një organizate ndërkombëtare.

Neni 34/c **Detyrimet e të pandehurit**

- I pandehuri detyrohet:
- a) t'u përgjigjet njoftimeve dhe thirrjeve të autoritetit procedues;
 - b) të njoftojë autoritetin procedues nëse planifikon të ndryshojë vendbanimin e tij të përkohshëm ose të përhershëm.”

Neni 25

Pika 1 e nenit 35, ndryshohet si vijon:

“1. Organi procedues është i detyruar t'i sigurojë të pandehurit të mitur praninë e një mbrojtësi, si edhe praninë e e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga autoriteti që procedon.”

Neni 26

Neni 37 ndryshohet si vijon:

“Neni 37 **Deklarimet që tregojnë vetëpërgjegjësi**

1. Kur një person, që nuk është marrë si i pandehur, bën deklarime, nga të cilat dalin të dhëna që tregojnë se ai mund të ketë kryer një vepër penale, autoriteti procedues ndërpret pyetjen, duke e paralajmëruar se pas këtyre deklarimeve mund të zhvillohen hetime ndaj tij dhe e fton të caktojë një mbrojtës. Deklarimet e mëparshme nuk mund të përdoren kundër personit që i ka bërë.”

Neni 27

Neni 38 ndryshohet si vijon:

“Neni 38 **Rregulla të përgjithshme për marrjen në pyetje**

1. I pandehuri, edhe kur është i arrestuar apo i burgosur për çdo lloj shkak, merret në pyetje i lirë, përveç rasteve kur duhen marrë masa për të parandaluar rrezikun e ikjes ose të dhunës.

2. Para se të fillojë pyetja, i pandehuri informohet për të drejtat dhe detyrimet e tij, të parashikuara nga nenet 34/a dhe 34/c të këtij Kodi.

3. Të pandehurit i kërkohet të deklarojë shprehimisht nëse do të zgjedhë një mbrojtës dhe lajmërohet se, nëse ai nuk zgjedh një të tillë, por mbrojtja është e detyrueshme sipas këtij Kodi, atij do t'i caktohet një mbrojtës ex officio.

4. I pandehuri mund të pyetet pa praninë e mbrojtësit nëse ka hequr dorë shprehimisht nga kjo e drejtë, nëse mbrojtësi është thirrur rregullisht, por nuk është paraqitur, dhe nuk ka mundësi që i pandehuri të sigurojë një mbrojtës tjetër ose nëse i pandehuri nuk ka siguruar praninë e mbrojtësit edhe pas kalimit të afatit prej 10 ditësh nga momenti që u informua për këtë të drejtë. Në rastet e mbrojtjes së detyrueshme, autoriteti procedues cakton një mbrojtës ex officio edhe në kushtet e parashikuara nga ky paragraf.

5. Nëse i pandehuri nuk është informuar apo nuk i është krijuar mundësia për të ushtruar të drejtat e parashikuara nga neni 34/a i këtij Kodi ose nëse deklarimi i tij për heqjen dorë nga e drejta për të patur mbrojtës, sipas paragrafit 4 të këtij neni, nuk është shënuar në procesverbal, ose nëse është vepruar në kundërshtim me parashikimet e paragrafit 4 të këtij neni, deklarimet e të pandehurit nuk mund të përdoren.”

Neni 28

Në paragrafin e parë të nenit 40 pas togfjalëshit “...për identifikimin e tij”, shtohet togfjalëshi “si dhe adresën e banimit.”

Neni 29

Pika 1 e nenit 47, ndryshohet si vijon:

“1.Nëse i pandehuri vdes gjatë procedimit, autoriteti procedues vendos pushimin e çështjes.”

Neni 30

Në nenin 48, pika 2 dhe 3 ndryshohen si vijon:

“2. Zgjedhja bëhet me deklaram të bërë para autoritetit procedues ose me prokurë të dhënë mbrojtësit ose të dërguar atij rekomande.

3.Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar, të dënuar me burgim dhe për të pandehurin në mungesë, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen, mund të bëhet nga një i afërm i tij, në format e parashikuara në paragrafin 2.”

Neni 31

Neni 49 ndryshohet si vijon:

“Neni 49 Mbrojtësi i caktuar

1. I pandehuri që kërkon të ketë mbrojtës, por nuk ka mjete financiare për të zgjedhur një të tillë, ndihmohet nga një mbrojtës i caktuar nga autoriteti që procedon.

2. Organi procedues është i detyruar, që personit nën hetim ti caktoj një mbrojtës edhe nëse nuk e kërkon, kur personi nën hetim, nuk ka më shume se arsimi i detyrueshem.

3. Kur i pandehuri është nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç ose me të meta fizike a psikike që e pengojnë atë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, ndihma nga një mbrojtës dhe konsultimi me një psikolog janë të detyrueshme.

4. Nëse i pandehuri nuk ka zgjedhur mbrojtës dhe verifikohet një nga situatat e parashikuara në paragrafin 2 apo 3 të këtij neni, autoriteti procedues i cakton atij një mbrojtës.

5. Këshilli drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Komisioni Shtetëror për Ndhimën Juridike venë në dispozicion të autoriteteve proceduese listat e avokatëve dhe vendos kriteret për caktimin e tyre.”

6. Mbrojtësi i caktuar mund t’i kërkojë autoritetit procedues heqjen dorë nga mbrojtja vetëm për arsye të përligjura.”.

Neni 32

VARIANTI I

Neni 51, ndryshohet si vijon:

“Neni 51 Detyrimet e mbrojtësit

1. Mbrojtësi i zgjedhur është detyruar të sigurojë mbrojtje efektive të interesave të të pandehurit brenda tagreve që i njej legjislacioni në fuqi.

2. Avokati i zgjedhur nga i pandehuri nuk mund të mungojë në gjykim pa një shkak të arsyeshëm. Në rastin e pengesës së arsyeshme për të qënë i pranishëm në séancë gjyqësore, avokati është i detyruar të caktojë një mbrojtës zëvendësues.

3. Mbrojtësi zëvendësues ushtron të drejtat dhe merr persiper detyrimet, edhe në rastet e mos aprovimit të tij nga i pandehuri, deri në sigurimin e mbrojtjes efektive për të, sipas afateve të parashikuara nga neni 55 i këtij Kodi.

4. Mbrojtësi i zgjedhur nuk mund të largohet nga seanca gjyqësore, në rast se i pandehuri mungon ose largohet nga seanca gjyqësore si dhe në rastet kur atij nuk i garantohet e drejta për mbrojtje.”

VARIANTI II

Pas nenin 50, shtohet neni 50/a me përmbajtjen si vijon:

“Neni 50/a

1. Mbrojtësi është i detyruar:

- a) t’i paraqesë pa vonesë prokurën autoritetit procedues;
- b) t’i japë ndihmë të pandehurit në mënyrë profesionale dhe në kohën e duhur;
- c) të mos abuzojë me të drejtat, në mënyrë që të zvarrisë procedimin;
- ç) të këshillojë të pandehurin për pasojat e heqjes dorë nga të drejtat;
- d) t’i japë ndihmë të pandehurit deri në caktimin e një mbrojtësi tjetër, në rast se i pandehuri ka revokuar prokurën.”

Neni 33

Në nenin 53, pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Në rastet e flagrancës, mbrojtësi i të pandehurit ka të drejtë të marrë pjesë në verifikimet e ngutshme në vend nga policia gjyqësore, nëse është e mundur dhe kur vonesa apo çdo shkak tjetër nuk u shkakton dëm hetimeve. Oficeri i policisë gjyqësore informon prokurorin për shkaqet e moslajmërimit të mbrojtësit”.

Neni 34

Pika 1 e nenit 56, ndryshohet si vijon:

“1. Organi procedues apo gjykata, njofton Këshillin Drejtues të Dhomës së Avokatëve për rastet e lënies së mbrojtjes, të refuzimit të mbrojtjes dhe të shkëljes nga ana e mbrojtësve të detyrave të besnikerisë dhe ndershmërisë. Për rastet e mësipërme, organi procedues apo gjykata i kërkon Këshillit Drejtues të Dhomës së Avokatëve, marrjen e masave disiplinore.”

Neni 35

Neni 58, ndryshohet si vijon:

“Neni 58

Të drejtat e viktimës së veprës penale

1. Viktima e veprës penale ka të drejtë:

- a) të kërkojë procedimin e fajtorit;
- b) të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe vendosjen e masave të përkohshme për të garantuar pagimin e dëmshpërblimit;
- c) të kërkojë mbledhjen e provave nga prokurori dhe të ankohet në gjykatë, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni për refuzimin e kësaj kërkesë;
- ç) të kërkojë informacion për gjendjen e procedimit në cdo kohë, si dhe të njihet me provat, pa çenuar parimin e sekretit hetimor;
- d) të njoftohet në kohë për çdo zhvillim të rëndësishëm të çështjes, veçanërisht për arrestimin/lirimin e të akuzuarit, pushimin e çështjes, fillimin dhe përfundimin e gjykimit;
- dh) të ankohet kundër vendimit të prokurorit për pushimin e procedimit;
- e) të thirret në seancën përgatitore dhe seancën e parë gjyqësore;
- ë) të dëgjohet nga gjykata, edhe nëse asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen si dëshmitar;
- f) të zgjedhë një përfaqësues dhe të përfitojë ndihmë ligjore falas, në kushtet e përcaktuara me ligj;
- g) të përjashtohet, në kushte të caktuara me ligj, nga pagimi i cdo takse apo tarife gjyqësore për paraqitjen e kërkesave që lidhen me statusin e viktimës.

2. Viktima që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat që i janë njohur me ligj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të tij.”

Neni 36

Neni 61 ndryshohet si vijon:

“Neni 61

Padia civile në procesin penal

1. Viktima ka të drejtë të paraqesë padi civile në procesin penal kundër të pandehurit ose të paditurit civil, për të kërkuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit material e jomaterial.”

Neni 37

Neni 63 ndryshohet si vijon:

“Neni 63 Sigurimi i padisë civile

1. Padiësi civil mund të kërkojë marrjen e masave të përkohshme, përfshirë sequestrimin e pasurisë së të pandehurit ose të të paditurit civil, për të garantuar kthimin e pasurisë dhe shpërblimin e dëmit. Kjo masë qëndron deri në përfundimin e çështjes.”

Neni 38

Në nenin 75/b, në fund të paragrafit 2 shtohet fjalia si vijon:

“Gjykata e Lartë gjykon me një gjyqtar për kërkesat e prokurorisë gjatë hetimeve për vepra penale të kryera nga këto subjekte”.

Neni 39

Pika 2, e nenit 98, ndryshohet si vijon:

Varianti I

“2. Personi që nuk flet gjuhën shqipe pyetet në gjuhën amtare, procesverbali mbahet në këtë gjuhë dhe në gjuhën shqipe. Organi procedues ka detyrim të vërë në dispozicion të gjitha aktet procedurale të përkthyer në gjuhën amtare të personit të përfshirë në një procedim penal, të cilat i jepen në bazë të kërkesës së tij.”

Varianti II

“2. Personi që nuk flet gjuhën shqipe pyetet në gjuhën amtare dhe procesverbali përkthehet edhe në këtë gjuhë. Në të njëjtën gjuhë përkthehen aktet procedurale që i jepen me kërkesën e tij”.

Neni 40

Neni 112, ndryshohet si vijon:

“1. Gjykata disponon me vendim përfundimtar, me vendime të ndërmjetme dhe me urdhra.

2. Vendimi përfundimtar jepet në emër të Republikës.

3. Vendimi përfundimtar dhe vendimet e ndërmjetme arsyetohen, ndryshe janë të pavlefshëm.

4. Vendimi përfundimtar dhe vendimet e ndërmjetme merren në dhomën e këshillimit, pa praninë e sekretarit dhe të palëve.

5. Mendimet paralele ose në pakicë të anëtarëve të trupit gjykues që nuk kanë votuar për atë që është vendosur i bashkangjiten vendimit.”.

6. Urdhrat merren pa u respektuar formalitete të veçanta dhe nuk parashikohet ndryshe, jepen me gojë.”

Neni 41

Neni 115 ndryshohet si vijon:

**“Neni 115
Dokumentimi i seancave gjyqësore**

1. Veprimet dokumentohen nëpërmjet regjistrimit audio të seancës gjyqësore.
2. Regjistrimi i seancës gjyqësore bëhet nga sekretari gjyqësor, nën udhëzimet dhe mbikëqyrjen e kryetarit të trupit gjykues.
3. Për çdo seancë gjyqësore të regjistruar, sekretari gjyqësor mban, me dorëshkrim ose shtypshkrim, procesverbalin e seancës, në të cilin shënohen viti, muaji, data dhe ora e fillimit dhe mbarimit të regjistrimit.
4. Kur është e pamundur të realizohet regjistrimi i seancës gjyqësore, për shkak të defekteve në pajisje ose përdorimit të tyre për ndonjë qëllim tjetër, kryetari i trupit urdhëron që procesverbali i seancës gjyqësore të mbahet fjalë për fjalë me dorëshkrim ose shtypshkrim.
5. Procesverbali i mbajtur sipas paragrafëve 2 dhe 4 të këtij neni nënshkruhet nga sekretari gjyqësor dhe nga kryetari i trupit gjykues.
6. Procesverbali, materiali i regjistrimit dhe transkripti i tij, nëse është bërë, bashkohen me dosjen gjyqësore.
7. Palët kanë të drejtë të marrin kopje të regjistrimit dhe procesverbalit në çdo kohë, përkundërt pagimit të tarifave përkatëse.
8. Rregulla më të detajuara për aspekte teknike të regjistrimit të seancave gjyqësore përcaktohen me urdhër të Ministrit të Drejtësisë.
9. Tarifat për marrjen e kopjeve të regjistrimeve dhe transkriptimin e këtyre regjistrimeve përcaktohen me urdhër të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave. Të ardhurat nga këto shërbime kalojnë në favor të buxhetit të gjykatës që i ofron ato.”

Neni 42

Neni 116 ndryshohet si vijon:

**“Neni 116
Elementët e domosdoshëm të regjistrimit**

1. Regjistrimi përmban gjithçka që ka ndodhur në seancën gjyqësore, të gjitha vendimet dhe urdhrat e gjykatës, si dhe të gjitha kërkesat, deklarimet dhe pretendimet e palëve. Regjistrimi fillon dhe mbaron në të njëjtën kohë me seancën gjyqësore.
2. Në çdo rast, regjistrimi duhet të tregojë:
 - a) përbërjen e trupit gjykues dhe emrin e sekretarit gjyqësor;
 - b) gjeneralitet e palëve, përfaqësuesve të tyre dhe personave që janë thirrur për të marrë pjesë në seancën gjyqësore;
 - c) nëse është rasti, shkaqet e mungesës së palëve, përfaqësuesve të tyre dhe personave që janë thirrur për të marrë pjesë në seancën gjyqësore.”

Neni 43

Neni 117 ndryshohet si vijon:

**“Neni 117
Përgatitja e transkriptit**

1. Transkripti i regjistrimit përgatitet nga sekretari gjyqësor në këto raste:
 - a) nëse kërkohet nga anëtarët e trupit gjykues;

b) nëse kërkohet nga palët në gjykim ose persona të tjerë të interesuar, me kusht që të paguhen tarifat e vendosura për këtë qëllim.

2. Transkriptimi i regjistrimit mund të bëhet për të gjitha seancat e një çështjeje, për seanca të vecanta ose për pjesë të shkëputura prej tyre, sipas kërkesës së personit që kërkon transkriptimin.

3. Transkriptimi mund të kërkohet edhe para se gjykata të ketë dhënë vendimin për çështjen.”

Neni 44

Neni 118 ndryshohet si vijon:

“Neni 118 Përmbajtja e transkriptit

1. Transkripti përmban të gjitha thëniet e gjykatës dhe pjesëmarrësve në seancën gjyqësore. Sekretari gjyqësor identifikon me saktësi në transkript çdo folës.

2. Transkripti nënshkruhet nga sekretari gjyqësor.

3. Nëse seanca gjyqësore është zhvilluar me praninë e përkthyesit, transkripti nënshkruhet edhe nga përkthyesi, për të vërtetuar saktësinë e përkthimit.”

Neni 45

Neni 128 ndryshohet si vijon:

“Neni 128 Pavlefshmëria absolute

1. Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme dhe nuk mund të bëhen të vlefshme në rast se nuk respektohen dispozitat që lidhen me:

a) kushtet për të qenë gjyqtar dhe numrin e gjyqtarëve që janë të domosdoshëm për formimin e trupave gjykues të përcaktuar në këtë Kod;

b) të drejtën e prokurorit për ushtrimin e ndjekjes penale dhe pjesëmarrjen e tij në procedim;

c) thirrjen e të pandehurit dhe praninë e mbrojtësit të tij, në rastet kur kjo e fundit është e detyrueshme.

2. Pavlefshmëritë e parashikuara nga paragrafi i parë i këtij neni konstatohen ex officio/ kryesisht në çdo fazë dhe shkallë të procedimit.

3. Mosrespektimi i dispozitave që lidhen me thirrjen e të dëmtuarit nga vepra penale ose të palëve private shkakton pavlefshmërinë absolute të akteve, por, në këto raste, pavlefshmëria nuk mund të konstatohet pas shpalljes së vendimit gjyqësor në shkallë të parë apo pas shpalljes së vendimit të gjykatës së apelit, nëse pavlefshmëria është verifikuar gjatë gjykimit në shkallë të parë.”.

Neni 46

Në nenin 191, në paragrafin e parë, fjala “përfaqësojnë” zëvendësohet me fjalën “tregojnë”.

Neni 47

Në nenin 193, në paragrafin 4, togfjalëshi “nga nenEt 364 dhe 367” ndryshohet me togfjalëshin “nga nenet 362 dhe 365”.

Neni 48

Neni 197 ndryshohet si vijon:

“Neni 197 Lëshimi i kopjeve

Me kërkesën e të interesuarit, gjykata mund të autorizojë sekretarinë të lëshojë kopje të vërtetuara të dokumentit të marrë si provë.”

Neni 49

Në nenin 198, në paragrafin e parë, togfjalëshi “organi procedues” ndryshohet me togfjalëshin “prokurori, gjatë hetimit paraprak, ose nga gjykata, gjatë gjykimit”.

Neni 50

Neni 199 ndryshohet si vijon:

“Neni 199 Këqyrja e personave

1. Këqyrja bëhet duke respektuar dinjitetin dhe integritetin vetjak të atij që këqyret si dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

2. Para se të bëhet këqyrja, personit që do të këqyret i bëhet e njohur e drejta për të kërkuar praninë e një personi të besuar, me kusht që ky të mund të gjendet menjëherë dhe të jetë i përshtatshëm.

3. Këqyrja mund të bëhet edhe me anën e një mjeku. Në këtë rast, prokurori ose gjykata mund të mos marrë pjesë në veprimin e këqyrjes.

4. Kur është e nevojshme për konstatimin e fakteve që kanë rëndësi për çështjen, lejohet marrja e gjakut, monstrave trupore dhe kryerja e ndërhyrjeve të tjera trupore, edhe pa vullnetin e personit, me kusht që të mos ketë rrezik për shëndetin e tij, të përdoret minimumi i forcës si dhe veprimet të bëhen nën mbikëqyrjen e mjekut ose e specialistit përkatës.

5. Mosrespektimi i kërkesave të paragrafëve 1, 2 dhe 4 e bën këqyrjen të pavlefshme.”

Neni 51

Në nenin 200, togfjalëshi “organi procedues” zëvendësohet me togfjalëshin “prokurori ose gjykata”.

Neni 52

Në nenin 201, paragrafi 2 ndryshohet si vijon:

“2. Prokurori ose gjykata mund të urdhërojnë, për arsye të motivuara, që të pranishmit të mos largohen nga vendi i këqyrjes para se të ketë përfunduar këqyrja dhe t'i kthejë forcërisht ata që largohen.”

Neni 53

Neni 202 ndryshohet si vijon:

**“Neni 202
Kushtet për kryerjen e kontrolleve**

1. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se dikush fsheh në personin e tij gjurmë të veprës penale ose sende me rëndësi për procedimin penal, gjykata merr vendim për kontrollin personal. Kur këto sende ndodhen në një vend të caktuar, vendoset kontrolli i vendit ose banesës.

2. Në raste të ngutshme që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontrolli, kontrolli personal ose i banesës autorizohet nga prokurori me vendim të arsyetuar. Në këto raste, prokurori njofton gjykatën menjëherë, por jo më vonë se njëzet e katër orë nga momenti i marrjes së vendimit. Brenda dyzet e tetë orëve nga momenti kur prokurori ka marrë vendimin, gjykata merr vendim të arsyetuar për vleftësimin e kontrollit si të ligjshëm ose jo. Kur vleftësimi nuk bëhet në afatin e caktuar, rezultatet e kontrollit nuk mund të përdoren dhe sendet e sekuestruara duhet të kthehen, përveç rastit kur janë sende të paligjshme.

3. Gjykata që ka nxjerrë vendimin mund të veprojë vetë ose të urdhërojë që veprimi të kryhet nga oficerët e policisë gjyqësore, të caktuar në vendimin e kontrollit.

4. Në rast flagrance ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur, që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontroll, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 298.”

Neni 54

Neni 203 ndryshohet si vijon:

**“Neni 203
Kërkesa e dorëzimit**

1. Kur kërkohet një send i caktuar, prokurori mund të kërkojë dorëzimin e tij. Në qoftë se sendi dorëzohet, kontrolli nuk bëhet, me përjashtim të rasteve kur, pas dorëzimit të sendit, krijohen arsye të bazuara për të besuar se nga kontrolli mund të zbulohen gjurmë apo sende të tjera.

2. Për të përcaktuar sendet që mund të sekuestrohen ose për të verifikuar rrethana të caktuara të nevojshme për hetimin, prokurori ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar prej tij, mund të kontrollojnë veprimet, dokumentet dhe korrespondencën pranë bankave.”

Neni 55

Në nenin 204, paragrafi 2, togfjalëshi “mbrojtje e” zëvendësohet me togfjalëshin “integritetin vetjak të”.

Neni 56

Në nenin 205, në paragrafin 1, togfjalëshi “ka në dispozicion” zëvendësohet me fjalën “posedon”.

Neni 57

Neni 206 ndryshohet si vijon:

**“Neni 206
Koha për kryerjen e kontrollit të banesës**

1. Kontrolli në një banesë ose në një vend të mbyllur ngjitur me të nuk mund të fillojë para orës shtatë dhe pas orës njëzet. Në raste të ngutshme, prokurori mund të urdhërojë me shkrim që kontrolli të fillojë jashtë këtij orari.”

Neni 58

Neni 207 ndryshohet si vijon:

**“Neni 207
Sekuestrimi gjatë kontrollit**

1. Gjatë kontrollit sekuestrohen sendet dhe dokumentat që kanë lidhje me qëllimin e kontrollit.

2. Nëse gjatë kontrollit zbulohen sende që nuk lidhen me veprën penale për të cilën është autorizuar kontrolli, por që tregojnë se mund të jetë kryer një veprë tjetër penale që ndiqet *ex officio/zyrtarisht*, këto sende përshkruhen në procesverbalin e kontrollit dhe sekuestrohen.

3. Nëse prokurori nuk kryen vetë kontrollin apo nuk merr pjesë në të, oficerët e policisë gjyqësore e njoftojnë atë menjëherë për ekzistencën e sendeve që duhet të sekuestrohen.”

Neni 59

Në nenin 208, paragrafët 1 dhe 2 ndryshohen si vijon:

“1. Prokurori urdhëron, me vendim të arsyetuar, sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve.

2. Sekuestrimin e kryen vetë prokurori që ka nxjerrë vendimin ose oficerët e policisë gjyqësore të deleguar me të njëjtin vendim.”

Neni 60

Neni 208/a, ndryshohet si vijon:

**“Neni 208/a
Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike**

1. Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike përfshin të drejtën për të hyrë, kërkuar dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme apo sigurimin e të dhënave të sistemit kompjuterik.

2. Kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të menduar se të dhënat e kërkuara kompjuterike janë memorizuar në një sistem tjetër kompjuterik apo në një pjesë të tij dhe këto të dhëna janë në mënyrë të ligjshme të kapshme prej sistemit kompjuterik fillestar që kontrollohet ose janë të disponueshme nga ky sistem, prokurori urdhëron menjëherë kërkimin ose hyrjen edhe në këtë sistem kompjuterik.

3. Sekuestrimi i të dhënave kompjuterike kryhet nga oficeri i policisë gjyqësore, i cili mund të asistohet edhe nga eksperti i caktuar nga prokurori për këtë qëllim.

4. Në zbatim të vendimit të prokurorit, oficeri i policisë gjyqësore dhe eksperti marrin masa:

- a) për të ndaluar kryerjen e veprimeve të mëtejshme ose për të siguruar sistemin kompjuterik, vetëm të një pjese të tij ose të një mjeti tjetër memorizimi të dhënash;
- b) për të nxjerrë dhe marrë kopje të të dhënave kompjuterike;
- c) për të penguar hyrjen në të dhënat kompjuterike, ose për t'i hequr këto të dhëna nga sistemet kompjuterike me të drejtë hyrjeje;
- ç) për të siguruar paprekshmërinë e të dhënave përkatëse, të memorizuara.”

Neni 61

Neni 209, numërohet neni 223/a i cili shtohet pas nenit 223 dhe ndryshohet me përmbajtje si vijon:

“Neni 223/a

Veprimet e sekuestrimit të korrespondencës

1. Gjykata urdhëron sekuestrimin e letrave, letrave me vlerë, zarfave, pakove, telegrameve dhe objekteve të tjera të korrespondencës që janë dërguar nga i pandehuri ose që i drejtohen atij, qoftë edhe me emër tjetër ose nëpërmjet një personi tjetër.
2. Kur sekuestrimin e kryen një oficer i policisë gjyqësore, ai duhet t'i dorëzojë prokurorit/gjyqtarit objektet e sekuestruara të korrespondencës pa i hapur dhe pa u njohur në ndonjë mënyrë tjetër me përmbajtjen e tyre.
3. Objektet e sekuestruara që nuk hyjnë në korrespondencën e sekuestrueshme i kthehen atij që i takojnë dhe nuk mund të përdoren.”

Neni 62

Neni 210 ndryshohet si vijon:

“Neni 210

Sekuestrimi pranë bankave

1. Prokurori mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumenteve, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjëje tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur nuk i përkasin të pandehurit ose kur nuk janë në emër të tij. Në këto raste, prokurori paraqet kërkesë për vleftësim në gjykatë brenda 48 orëve nga vendosja e sekuestros. Nëse gjykata nuk e vleftëson sekuestrimin të ligjshëm brenda 48 orëve nga marrja e kërkesës, sekuestroja bie dhe sendet duhet të kthehen.”

Neni 63

Neni 211 ndryshohet si vijon:

“Neni 211

Detyrimi i dorëzimit dhe ruajtja e sekretit

1. Personat e detyruar për ruajtjen e sekretit profesional ose shtetëror detyrohen t'i dorëzojnë menjëherë prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore aktet dhe dokumentet, edhe në origjinal, dhe çdo gjë tjetër që ruhet pranë tyre për shkak të detyrës, shërbimit ose

profesionit, përveç kur deklarojnë se është sekret shtetëror ose sekret që lidhet me detyrën a profesionin e tyre. Në rastin e fundit bëhen verifikimet e nevojshme dhe kur del që deklarimi është i pabazuar, prokurori urdhëron sekuestrimin.

2. Kur sekreti shtetëror konfirmohet nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore dhe prova është thelbësore për zgjidhjen e çështjes, prokurori vendos marrjen e provës.

3. Kur brenda tridhjetë ditëve nga kërkesa organi kompetent nuk jep konformimin e sekretit, prokurori urdhëron sekuestrimin.”

Neni 64

Neni 221 ndryshohet si vijon:

“Neni 221 Kufijtë e lejimit

1. Përgjimi dhe regjistrimi i komunikimeve që kryhen me telefon ose me çdo mjet tjetër teknik, vëzhgimi dhe regjistrimi i fshehtë audio dhe/ose video në vende private, marrja e të dhënave për trafikun e komunikimeve hyrëse dhe dalëse telefonike, vëzhgimi i adreses elektronike apo çdo lloj adrese tjetër dhe sekuestrimi i korrespondencës lejohen vetëm kur procedohet:

a) për krime të kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se katër vjet;

b) për kundërvajtjet penale të fyerjes e të kanosjes, të kryera me mjete të komunikimit;

2. Vëzhgimi, fotografimi dhe regjistrimi i fshehtë audio dhe/ose video në vende publike dhe përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes lejohen kur procedohet për krime të kryera me dashje.

3. Veprimet e parashikuara nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni urdhërohen kundër:

a) të dyshuarit për kryerjen e një vepre penale;

b) personit që dyshohet se merr ose transmeton komunikime nga i dyshuari;

c) personit që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin;

ç) personit, vëzhgimi i të cilit mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose të identitetit të të dyshuarit.

4. Rezultati i përgjimit dhe vëzhgimit është i vlefshëm kundër të gjithë komunikuesve.

5. Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si provë.

6. Mosrespektimi i parashikimeve të paragrafëve 1, 2 dhe 3 të këtij neni i bën rezultatet e përgjimit ose të vëzhgimit të papërdorshme.”

Neni 65

Neni 222 ndryshohet si vijon:

“Neni 222 Lejimi i përgjimit

1. Përgjimi dhe regjistrimi i komunikimeve që kryhen me telefon ose me çdo mjet tjetër teknik, vëzhgimi dhe regjistrimi i fshehtë audio dhe/ose video në vende private, vëzhgimi i adreses elektronike apo çdo lloj adrese tjetër dhe sekuestrimi i korrespondencës lejohen nga gjykata me vendim të motivuar, mbi kërkesën e prokurorit ose të të dëmtuarit akuzues. Përveç kushteve të parashikuara në paragrafët 1 dhe 3 të nenit

221, kërkuesi duhet të argumentojë pse veprimi është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara, si edhe të tregojë se ekzistojnë indicie të rëndësishme fajësie.

2. Gjykata merr vendim në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve. Kundër vendimit të gjykatës që refuzon kërkesën mund të bëhet ankim i veçantë.

3. Vendimi i gjykatës tregon mënyrën e kryerjes dhe kohëzgjatjen e veprimeve, e cila nuk mund t'i kalojë pesëmbëdhjetë ditët. Me kërkesë të prokurorit ose të të dëmtuarit akuzues, ky afat mund të zgjatet nga gjykata sa herë është e nevojshme, por secila zgjatje nuk mund të jetë më e gjatë se 40 ditë, kur procedohet për krime që janë në kompetencë të gjykatave për krimet e rënda, dhe 20 ditë, kur procedohet për krime të tjera dhe kundërvajtje. Kërkesa për zgjatjen pranohet nëse vazhdojnë të ekzistojnë kushtet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Vendimi i gjykatës për lejimin e vëzhgimit ose regjistrimit të fshehtë audio dhe/ose video në vende private përmban edhe autorizimin e hyrjes së fshehtë të oficerit të policisë gjyqësore ose specialistit të kualifikuar në këto vende, për të realizuar veprimet e nevojshme për zbatimin e vendimit. Ky autorizim duhet të zbatohet brenda 10 ditëve. Nëse autorizimi zbatohet tej këtij afati, rezultatet nuk mund të përdoren.

5. Prokurori vepron vetë ose me anën e një oficeri të policisë gjyqësore për zbatimin e vendit.

6. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se nga vonesa mund t'i vijë një dëm i rëndë hetimeve, prokurori vendos të kryejë veprimet e parashikuara nga paragrafi 1 me vendim të motivuar dhe njofton gjykatën menjëherë, por jo më vonë se njëzet e katër orë nga momenti i marrjes së vendimit. Brenda dyzet e tetë orëve nga momenti kur prokurori mori vendimin, gjykata merr vendim të arsyetuar për vleftësimin e përgjimit të ligjshëm ose jo. Kur vleftësimi nuk bëhet në afatin e caktuar, veprimi nuk mund të vazhdojë dhe rezultatet e tij nuk mund të përdoren.

7. Kur njëri nga bashkëbiseduesit është i gatshëm të kryejë regjistrimin dhe plotësohen të gjithë kushtet e parashikuara nga paragrafi 1 i këtij neni, regjistrimi audio dhe/ose video autorizohet nga prokurori.

8. Në regjistrin që mbahet në prokurori shënohen aktet që lejojnë, autorizojnë, vleftësojnë ose zgjasin veprimet e parashikuara nga paragrafin 1 të këtij neni, si dhe fillimin e mbarimit të zbatimit të çdo akti.”

Neni 66

Neni 222/a numërohet neni 222/b.”

Neni 67

Pas nenit 222 shtohet neni 222/a si vijon:

“Neni 222/a Lejimi i vëzhgimit

1. Vëzhgimi, fotografimi dhe regjistrimi i fshehtë audio dhe/ose video në vende publike, përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes marrja e të dhënave për trafikun e komunikimeve hyrëse dhe dalëse telefonike autorizohen nga prokurori.

2. Në regjistrin që mbahet në prokurori shënohen aktet që lejojnë, autorizojnë, vleftësojnë ose zgjasin veprimet e parashikuara nga paragrafin 1 të këtij neni, si dhe fillimin e mbarimit të zbatimit të çdo akti.”

Neni 68

Neni 223 ndryshohet si vijon:

“Neni 223

Veprimet e përgjimit të komunikimeve

1. Veprimet e përgjimit të komunikimeve që kryhen me telefon ose me çdo mjet tjetër teknik kryhen vetëm me anën e pajisjeve që administrohen nga Prokurori i Përgjithshëm.

2. Kur konstaton se njëri nga kushtet e përgjimit nuk ekziston më, oficeri i policisë gjyqësore njofton menjëherë prokurorin, i cili urdhëron ndalimin e përgjimit dhe vë në dijeni gjykatën.

3. Komunikimet e përgjuara regjistrohen dhe për veprimet e kryera mbahet procesverbal.

4. Procesverbalet dhe regjistrimet i dorëzohen menjëherë prokurorit dhe, brenda pesë ditëve nga mbarimi i veprimeve, ato depozitohen në sekretari bashkë me aktet që kanë urdhëruar, autorizuar, vleftësuar dhe zgjatur përgjimin. Kur nga depozitimi mund të dëmtohen hetimet, gjykata autorizon prokurorin që ta shtyjë depozitimin deri në përfundimin e hetimeve paraprake.

5. Mbrojtësit dhe përfaqësuesit e palëve lajmërohen menjëherë për depozitimin në sekretari dhe për të drejtën që kanë për të shqyrtuar aktet e për të marrë kopje të regjistrimeve dhe të transkripteve që mund të jenë bërë nga prokurori.”

Neni 69

Neni 224 ndryshohet si vijon:

“Neni 224

Ruajtja e dokumentacionit

1. Procesverbalet dhe regjistrimet ruhen pranë prokurorisë që ka kryer përgjimin, derisa vendimi të marrë formë të prerë, me përjashtim të regjistrimeve të papërdorshme. Por, kur ky dokumentacion nuk është i nevojshëm, të interesuarit mund të kërkojnë asgjësimin e tij. Mbi këtë kërkesë vendos gjykata që ka lejuar përgjimin. Asgjësimi bëhet nën kontrollin e gjyqtarit dhe për veprimin mbahet procesverbal.

2. Kur prokurori vendos pushimin e procedimit, gjatë të cilit janë kryer përgjime, ai i drejtohet gjykatës me kërkesë për asgjësimin e regjistrimeve, procesverbalet dhe transkripteve të kryera. Gjkata vendos në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve.”

Neni 70

Në neni 225, në paragrafin e parë, pas fjalëve “në procedime të tjera” shtohen fjalët “për vepra penale për të cilat lejohet përgjimi në përputhje me nenin 221”.

Neni 71

Neni 226 ndryshohet si vijon:

“Neni 226

Ndalimi i përdorimit

1. Rezultatet e përgjimit dhe vëzhgimit nuk mund të përdoren në rastet e parashikuara në dispozitat e këtij seksioni.

2. Nuk mund të përdoren përgjimet komunikimeve të atyre që janë të detyruar të ruajnë sekretin për shkak të profesionit apo detyrës, me përjashtim të rasteve kur këta persona kanë dëshmuar mbi të njëjtat fakte ose i kanë përhapur në ndonjë mënyrë tjetër.”

Neni 72

Kudo në titullin V “Masat e sigurimit”, hiqet termi “personal”.

Neni 73

Neni 228 ndryshohet si vijon:

“Neni 228 Nevojat e sigurimit

1. Masat e sigurimit vendosen ndaj një personi për të cilin ekzistojnë, indicie të rëndësishme fajësie se ka kryer një veprë penale në këto raste:

- a) kur ai është larguar ose ekziston rreziku real që të largohet ose, në cilësinë e të pandehurit, është e qartë se po i shmanget pjesëmarrjes në gjykim atëherë kur ajo është e detyrueshme;
- b) kur ekzistojnë rrethana konkrete që tregojnë se ai do të shkatërrojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë prova ose gjurmë të veprës penale ose do të pengojë procedimin, nëpërmjet ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët ose bashkëpunëtorët e tij;
- c) kur ekzistojnë rrethana konkrete që tregojnë se, brenda një kohe të shkurtër, ai do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një veprë penale të mbetur në tentativë ose do të kryejë një veprë tjetër penale.”

Neni 74

Neni 229 ndryshohet si vijon:

“Neni 229 Kushtet e përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit

1. Në caktimin e masave të sigurimit, gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e masës me nevojat reale të sigurimit, me rëndësinë e faktit dhe me dënimin që parashikohet për veprën penale. Nuk mund të caktohet një masë sigurimi më e rëndë nëse i njëjti qëllim mund të realizohet me anë të një mase më të lehtë.

2. Kur kërkohet të caktohet masë sigurimi ndaj një të mituri, gjykata mban parasysh interesin e tij më të lartë dhe kërkesën për të mos ndërprerë proceset edukative konkrete.

3. Nuk mund të caktohet masë sigurimi nëse ka shkaqe që shuajnë veprën penale apo shkaqe që sjellin padënueshmërinë e personit.

4. Nëse çmohet e domosdoshme për nevojat konkrete të sigurimit, ndaj një personi mund të caktohet më shumë se një masë sigurimi.

5. Nëse caktohet masë sigurimi në kushtet e pikës b të nenit 228, gjykata cakton edhe afatin brenda të cilit prokurori duhet të marrë të gjitha masat për të garantuar provat dhe gjurmët e veprës penale.”

Neni 75

Neni 230 ndryshohet si vijon:

“Neni 230

Kushtet e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg

1. Arresti në burg mund të caktohet vetëm kur çdo masë tjetër sigurimi është e pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e sigurimit për shkak të rrezikshmërisë së lartë të veprës dhe të pandehurit.

2. Arresti në burg nuk mund të caktohet ndaj të miturve që akuzohen për kryerjen e kundërvajtjeve penale, ndaj një gruaje që është shtatzënë ose me fëmijë me gji, ndaj një personi që ndodhet në gjendje shëndetësore veçanërisht të rëndë ose që ka kaluar moshën shtatëdhjetë vjeç ose një personi toksikoman apo të alkolizuar, për të cilin zbatohet një program terapeutik në një institucion të posaçëm.

3. Në rastet e parashikuara në pikën 2, me përjashtim të të miturve që kanë kryer kundërvajtje penale, arresti në burg mund të vendoset vetëm kur ka shkaqe të një rëndësie të veçantë për krimet që dënohen jo më pak në maksimum se dhjetë vjet burgim.

4. Të gjithë autoritetet e përfshira në procedimin penal kanë detyrim të marrin masat e nevojshme për të siguruar që personi të mbahet në arrest në burg për një kohë sa më shkurtër dhe që procedimi të përfundojë sa më shpejt kur i pandehuri ndodhet në arrest në burg.

5. Arresti në burg do të revokohet menjëherë sapo të pushojnë së ekzistuari arsyet që diktuan caktimin e tij.”

Neni 76

Në nenin 232 gërma d) ndryshohet si vijon:

“d) detyrimi për të mos u larguar nga banesa;”

Neni 77

Neni 233 ndryshohet si vijon:

“Neni 233

Ndalimi i daljes jashtë shtetit

1. Me vendimin që urdhëron ndalimin e daljes jashtë shtetit, gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e shprehur të saj.

2. Në vendim, gjykata cakton detyrat e nevojshme për të siguruar zbatimin e vendimit, mënyrën e ndalimit të përdorimit të pasaportës e të dokumenteve të tjera të vlefshme për daljen jashtë shtetit.

3. Kjo masë urdhërohet edhe atëherë kur ndaj personit duhet të caktohet ose është caktuar më parë masa e arrestit në burg për shkaqet e parashikuara nga pika a) e nenit 228, por ai, me vullnetin e tij të lirë, kërkon ose pranon vendosjen e njëkohshme nën mbikëqyrje elektronike.”

Neni 78

Në nenin 234, paragrafi 1, pas fjalëve “policisë gjyqësore” shtohen fjalët “ose para një oficeri të caktuar të policisë gjyqësore”.

Neni 79

Në nenin 235, paragrafët 4 dhe 5 ndryshohen si vijon:

“4. Kjo masë urdhërohet edhe atëherë kur ndaj personit duhet të caktohet ose është caktuar më parë masa e arrestit në burg për shkaqet e parashikuara nga pika a) e nenit 228, por ai, me vullnetin e tij të lirë, kërkon ose pranon vendosjen e njëkohshme nën mbikëqyrje elektronike.

5. Njësia e policisë, e caktuar sipas paragrafit 3 të këtj neni, është përgjegjëse për mbikëqyrjen e respektimit të masës dhe për raportimin e çdo shkeljeje tek prokurori.”

Neni 80

Neni 236 ndryshohet si vijon:

“Neni 236 Garancia pasurore

1. Personi, ndaj të cilit duhet të caktohet ose është caktuar më parë masa e arrestit në burg për shkaqet e parashikuara nga paragrafi i tretë, pika a) e nenit 228, mund të qëndrojë i lirë ose të lirohet nga arresti në burg, nëse ai vetë ose një person tjetër për llogari të tij ofron garanci pasurore që ai nuk do të largohet deri në marrjen e vendimit përfundimtar për çështjen.

2. Garancia pasurore është gjithmonë një shumë parash, e përcaktuar nga gjykata duke mbajtur parasysh nevojat reale të sigurimit, rrethanat personale dhe familjare të të pandehurit dhe gjendjen e tij financiare.

3. Caktimi i garancisë pasurore mund të kërkohet nga prokurori, i pandehuri ose mbrojtësi i tij. Gjykata duhet të marrë mendimin e palës tjetër në lidhje me ekzistencën e kushteve për caktimin e garancisë edhe shumën e saj, por kryen vlerësimin e vet të pavarur të kushteve dhe shumës që duhet dhënë si garanci.

4. Kur vendos të caktojë garanci pasurore, gjykata përcakton shumën që duhet të depozitohet dhe afatin, brenda të cilit duhet të kryhet depozitimi. I pandehuri qëndron në arrest në burg deri në përfundim të këtij afati.

5. Pas përfundimit të afatit, gjykata verifikon nëse personi ka kryer depozitimin e shumës së caktuar si garanci pasurore dhe, brenda 24 orëve nga momenti i përfundimit të afatit, urdhëron lirimin e tij ose caktimin e arrestit në burg si masë sigurimi. Kur urdhëron lirimin, gjykata përcakton edhe kushtet e garancisë pasurore të parashikuara në paragrafin e parë, shkronjat a), b) dhe c) të nenit 232. Gjykata vendos në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve.

6. Nëse i pandehuri shkel kushtet e garancisë pasurore, gjykata urdhëron konfiskimin e shumës së vendosur si garanci dhe caktimin e masës së arrestit në burg.”

Neni 81

Neni 237 ndryshohet si vijon:

“Neni 237 Detyrimi për të mos u larguar nga banesa

1. Me vendimin që e detyron të mos largohet nga banesa, gjykata urdhëron të pandehurin të mos largohet nga banesa e tij e përhershme, e përkohshme ose e zgjedhur ose nga një vend i caktuar ku ai qëndron, kurohet ose mbahet me asistencë.

2. Kur është e nevojshme, gjykata urdhëron edhe ndalimin e komunikimeve me persona të tjerë, me përjashtim të anëtarëve të familjes, personave që bashkëjetojnë me të dhe mbrojtësit.

3. Masa e detyrimit për të mos u larguar nga banesa urdhërohet edhe atëherë kur ndaj personit duhet të caktohet ose është caktuar më parë masa e arrestit në burg për shkaqet e parashikuara nga pika a) e nenit 228, por ai, me vullnetin e tij të lirë, kërkon ose pranon vendosjen e njëkohshme nën mbikëqyrje elektronike.

4. Prokurori, policia gjyqësore dhe autoriteti i ngarkuar nga ligji me mbikëqyrjen elektronike kontrollojnë respektimin e vendimit të gjykatës.”

Neni 82

Pas nenit 239, shtohet neni 239/1 me përmbajtje si vijon:

“Neni 239/a

Rregulla për vendosjen nën mbikëqyrje elektronike

1. Gjykata urdhëron vendosjen e personit nën mbikëqyrje elektronike në kushtet e parashikuara nga nenet 233, paragrafi 3, 235, paragrafi 4 dhe 237, paragrafi 3 i këtij Kodi.

2. Gjykata mund të urdhërojë vendosjen e personit nën mbikëqyrje elektronike edhe për të garantuar zbatimin e masave të parashikuara nga pikat a), c) dhe d) të nenit 232 të këtij Kodi, por vetëm pasi të ketë marrë pëlqimin e personit.

3. Pëlqimi për përdorimin e mbikëqyrjes elektronike jepet me shkrim ose nëpërmjet deklaramit në seancë gjyqësore. Në rastin e të miturve, pëlqimi duhet të jepet në të njëjtën formë edhe nga prindërit ose kujdestari i tij ligjor.

4. Pasi merr pëlqimin e personit, gjykata sigurohet që ai i kupton të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga përdorimi i mbikëqyrjes elektronike.

5. Nëse personi nuk jep pëlqimin, sipas paragrafit 4 të këtij neni, gjykata nuk mund të urdhërojë përdorimin e mbikëqyrjes elektronike, por ky fakt mbahet në konsideratë prej saj, së bashku me rrethanat e tjera të çështjes, në përcaktimin e masës shtrënguese.

6. Përdorimi i mbikëqyrjes elektronike mund të jetë me ose pa afat. Nëse gjykata nuk ka përcaktuar afat, kohëzgjatja e përdorimit është e barabartë me kohëzgjatjen e masës shtrënguese.

7. Rregulla më të detajuara për aspektet teknike, zbatimin dhe administrimin e mbikëqyrjes elektronike përcaktohen me ligj të veçantë.”

Neni 83

Neni 240 ndryshohet si vijon:

“Neni 240

Llojet e masave ndaluese

Masat ndaluese janë:

a) pezullimi nga funksioni publik ose ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të një shërbimi publik;

b) ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të një veprimtarie profesionale ose tregtare.”

Neni 80

Në nenin 242, paragrafi 2, ndryshohet si vijon:

“2. Masa e parashikuar nga pika a) e nenit 240 të këtij Kodi nuk mund të caktohet ndaj funksionarëve të zgjedhur qendrorë ose vendorë.”

Neni 84

Titulli i nenit 243 ndryshohet si vijon:

“Ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të një veprimtarie profesionale ose tregtare.”

Neni 85

Në nenin 244, paragrafi 1, ndryshohet si vijon:

“1. Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, e cila duhet të përmbajë faktet e rëndësishme dhe rrethanat specifike të çështjes, të cilat çojnë në përfundimin se caktimi i një mase sigurie është i përligjur; diskutimin e arsyeve pse masa e kërkuar e sigurisë është e përshtatshme dhe proporcionale, si edhe diskutimin e rrethanave në favor të të pandehurit dhe argumentave të paraqitur nga mbrojtja deri në atë fazë.”.

Neni 86

Pas nenit 244, shtohet neni 244/a, si vijon:

“Neni 244/a Gjykata kompetente

1. Gjatë fazës së hetimit paraprak, të gjithë vendimet në lidhje me masat e sigurimit merren nga gjyqtari i përcaktuar nga neni 278 i këtij Kodi.
2. Gjatë fazës së gjykimit, të gjithë vendimet në lidhje me masat e sigurimit merren nga trupi gjykues që shqyrton çështjen.
3. Kompetenca tokësore dhe lëndore për shqyrtimin e kërkesave që lidhen me masat e sigurimit përcaktohet nga rregullat e përgjithshme për kompetencën.
4. Nëse kërkesa është paraqitur para gjykatës që nuk është kompetente dhe rrethanat e çështjes kërkojnë një vendimmarrje të shpejtë, gjykata vendos për caktimin e masës së sigurimit dhe zbaton nenin 88 të këtij Kodi.”

Neni 87

Neni 245 ndryshohet si vijon:

“Neni 245 Vendimi i gjykatës

1. Vendimi për caktimin e masës së sigurimit përmban:
 - a) gjeneralitetet e personit ndaj të cilit merret masa ose çdo gjë tjetër që vlen për ta identifikuar atë dhe, kur është e mundur, tregimin e vendit ku ndodhet;

b) parashtrimin përmbledhës të fakteve, duke treguar nenet e ligjit që konsiderohen të shkelur;

c) arsyetimin e detajuar dhe individual të fakteve të rëndësishme dhe rrethanave specifike të çështjes, të cilat çojnë në përfundimin se caktimi i një mase sigurie është i përligjur;

ç) diskutimin e arsyeve pse masa konkrete e sigurisë është e përshtatshme dhe proporcionale;

d) diskutimin e rrethanave në favor të të pandehurit dhe argumentave të paraqitur nga mbrojtja;

e) kohëzgjatjen e masës, të përcaktuar sipas paragrafit 5 të nenit 229 të këtij Kodi.”

Neni 88

Neni 246 ndryshohet si vijon:

“Neni 246

Zbatimi i masave të sigurimit

1. Vendimet për caktimin e masave të sigurimit i njoftohen të pandehurit nga gjykata.

2. Në rast se dyshohet për vërtetësinë e vendimit që ka caktuar masën e sigurimit ose për identitetin e personit ndaj të cilit është dhënë masa, oficerët e policisë gjyqësore nuk e zbatojnë atë.

3. Pas njoftimit ose zbatimit të tyre, vendimet depozitohen në sekretarinë e gjykatës që i ka dhënë. Për depozitimin njoftohen edhe mbrojtësit.

4. Kopja e vendimit, me të cilin është caktuar një masë ndaluese i dërgohet organit që është kompetent për të vendosur caktimin e një mase të tillë në rastet e zakonshme.”

Neni 89

Pas nenit 246, shtohet neni 246/a, me këtë përmbajtje:

“Neni 246/a

Zbatimi i masës së arrestit në burg

1. Oficeri i policisë gjyqësore, i ngarkuar me zbatimin e vendimit të arrestit në burg i dorëzon personit ndaj të cilit është marrë masa kopjen e vendimit. Gjatë zbatimit të vendimit, oficeri i policisë gjyqësore sigurohet që personit t’i respektohen të drejtat e parashikura në Kreun IV këtij Kodi. Për veprimet e kryera mbahet procesverbal, i cili i dërgohet gjykatës që ka dhënë vendimin dhe prokurorit.

2. Në rastet e parashikuara nga nenet 73, paragrafi 2, 126 dhe 137, paragrafët 2 dhe 4 të Kushtetutës, vendimi i gjykatës i dërgohet autoritetit përkatës, së bashku me kërkesën për të autorizuar zbatimin e tij. Vendimi i gjykatës mund të zbatohet vetëm pasi të jetë dhënë autorizimi për të kryer arrestimin.

3. Çdo dy muaj nga zbatimi i vendimit të arrestit, prokurori informon gjykatën me shkrim në lidhje me gjendjen e procedimit, veprimet e kryera hetimore dhe vazhdimësinë e nevojave të sigurimit. Kur e cmon të arsyeshme, gjykata mund të dëgjojë edhe mbrojtjen dhe të urdhërojë revokimin ose zëvendësimin e masës së sigurimit. Nëse informacion nuk jepet në kohën e duhur, gjykata thërret palët në seancë dhe, pasi i dëgjon ato, urdhëron vazhdimin e zbatimit të masës, revokimin ose zëvendësimin e saj.”

Neni 90

Neni 247, ndryshohet si vijon:

“Neni 247

Kërkimi i personit që nuk gjendet

1. Kur personi ndaj të cilit është marrë masa nuk gjendet, oficeri ose agjenti i policisë gjyqësore mban procesverbal, në të cilin tregon kërkimet e bëra dhe ia dërgon atë gjykatës që ka dhënë vendimin.
2. Kur gjykata çmon se kërkimet janë bërë të plota, deklaron ikjen e personit dhe, nëse e cmon të arsyeshme, cakton një masë sigurimi më të rëndë ose një masë sigurimi shtesë.
3. Me vendimin që deklaron ikjen, gjykata i cakton personit që ka ikur një mbrojtës dhe urdhëron që të depozitohet në sekretari kopja e vendimit me të cilin është caktuar masa e zbatuar.
4. Me të ikurin barazohet, për çdo efekt, i larguari nga vendi ku ruhet.”

Neni 91

Në nenin 248, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“Neni 248

Marrja në pyetje e personit të arrestuar

1. Jo më vonë se 48 orë nga zbatimi i masës, gjykata merr në pyetje personin për të cilin ka vendosur arrestin në burg. I pandehuri ka të drejtë të kundërshtojë masën e arrestit, duke paraqitur fakte të cilat e shfajësojnë ose lehtësojnë pozitën e tij.”

Neni 92

Neni 249 ndryshohet si vijon:

“Neni 249

Ankimi kundër masave të sigurimit

1. Brenda dhjetë ditëve nga zbatimi ose njoftimi i vendimit të gjykatës, në bazë të të cilit është marrë ose është refuzuar një masë sigurimi, prokurori, i pandehuri ose mbrojtësi i tij mund të bëjnë ankim në gjykatën më të lartë.
2. Për të pandehurin e ikur afati fillon të ecë nga data e njoftimit të bërë sipas nenit 141.
3. Ankimi paraqitet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, e cila detyrohet që brenda 5 ditëve të dorëzojë aktet në gjykatën që do të shqyrtojë ankimin.
4. Kërkesa shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve.
5. Data e caktuar për seancën i njoftohet prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij të paktën tri ditë përpara.
6. Gjkata e apelit vendos, sipas rastit, shfuqizimin, ndryshimin ose miratimin e vendimit. Gjkata e apelit e shqyrton në çështjen në tërësi dhe nuk kufizohet vetëm në shkaqet e parashtruara në ankim ose në ato të treguara në pjesën arsyetuese të vendimit.
7. Kur vendimi nuk shpallet brenda afatit të caktuar, vendimi në bazë të të cilit është marrë masa e sigurimit e humbet fuqinë.

8. Kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë.
9. Gjykata e Lartë vendos brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve.”

Neni 93

Neni 250 ndryshohet si vijon:

“Neni 250

Llogaritja e afateve të kohëzgjatjes së arrestit në burg

1. Efektet e arrestit në burg fillojnë të ecin nga çasti i arrestimit ose i ndalimit.
2. Kur i pandehuri është i arrestuar për një veprë penale tjetër, efektet e masës fillojnë të ecin nga dita në të cilën është njoftuar vendimi.
3. Efektet e masave të tjera fillojnë të ecin nga çasti në të cilin vendimi i është njoftuar personit.
4. Kur ndaj një të pandehuri janë dhënë disa vendime që caktojnë të njëjtën masë për të njëjtin fakt, afatet fillojnë të ecin nga dita në të cilën është zbatuar ose njoftuar i pari.”

Neni 94

Neni 253 ndryshohet si vijon:

“Neni 253

Ndalimi i të dyshuarit për një krim

1. Kur ka shkaqe të bazuara për të menduar se ka rrezik ikjeje, prokurori urdhëron ndalimin e personit që dyshohet për një krim, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet.”

Neni 95

Neni 256 ndryshohet si vijon:

“Neni 256

Marrja në pyetje e të arrestuarit ose të ndaluarit

1. Prokurori merr në pyetje të arrestuarin ose të ndaluarin në prani të mbrojtësit të zgjedhur ose të caktuar kryesisht. Ai i njofton të arrestuarit ose të ndaluarit faktin për të cilin procedohet dhe arsyet e marrjes në pyetje, duke i treguar të dhënat në ngarkim të tij dhe, kur nuk i shkaktohet dëm hetimeve, edhe burimet.”

Neni 96

Neni 257 ndryshohet si vijon:

“Neni 257

Rastet e lirimit të menjëhershëm të të arrestuarit ose të ndaluarit

1. Kur del e qartë se arrestimi ose ndalimi është bërë për shkak se është ngatërruar personi ose nuk janë respektuar kërkesat e ligjit ose kur masa e arrestit ose e ndalimit e ka humbur fuqinë për shkak të shkeljes së afatit të kërkesës për vleftësimin e masës,

prokurori urdhëron, me vendim të motivuar, që i arrestuari ose i ndaluari të lirohet menjëherë. Në këto raste lirimi urdhërohet edhe nga oficeri i policisë gjyqësore, i cili njofton menjëherë prokurorin e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.”

Neni 97

Neni 259 ndryshohet si vijon:

“Neni 259

Seanca e vleftësimit

1. Seanca e vleftësimit zhvillohet me pjesëmarrjen e domosdoshme të prokurorit dhe të mbrojtësit. Kur mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar ex officio nuk është gjetur ose nuk është paraqitur, gjykata cakton si zëvendësues një mbrojtës tjetër.

2. Prokurori tregon shkaqet e arrestimit ose të ndalimit. Pas kësaj gjykata dëgjon të arrestuarin ose të ndaluarin dhe mbrojtësin ose vetëm këtë të fundit, kur i arrestuari a i ndaluari ka refuzuar të paraqitet. Në rastet e të miturve, refuzimi duhet të konstatohet nga mbrojtësi. Provat e marra në këtë seancë si dhe deklaratimet e të arrestuarit apo ndaluarit në këtë seancë do të konsiderohen si të marra në gjykim.

3. Kur del se arrestimi ose ndalimi janë bërë në mënyrë të ligjshme, gjykata merr vendim për vleftësimin e masës. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet apel në gjykatën më të lartë nga prokurori dhe i arrestuari ose i ndaluari dhe, kur ka kërkesë nga prokurori, gjykata cakton masën e sigurimit.

4. Kur arrestimi ose ndalimi nuk është i ligjshëm, gjykata vendos lirimin e menjëhershëm të të arrestuarit ose të ndaluarit. Kundër vendimit mund të bëhet apel ose rekurs i drejtpërdrejtë nga prokurori.

5. Arrestimi ose ndalimi e humbet fuqinë kur vendimi i gjykatës për vleftësimin nuk është shpallur brenda dyzet e tetë orëve të ardhshme nga çasti në të cilin kërkesa e prokurorit është paraqitur në gjykatë.”

Neni 98

Neni 260 ndryshohet si vijon:

“Neni 260

Revokimi, zëvendësimi dhe bashkimi i masave të sigurimit

1. Masat e sigurimit revokohen menjëherë kur del se mungojnë kushtet e zbatimit të tyre. Kërkesa për revokimin e masave të sigurimit mund të bëhet nga secila palë, në çdo kohë.

2. Në çdo kohë që rriten nevojat e sigurimit apo personi shkel detyrimet që lidhen me masën e sigurimit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, mund të vendosë zëvendësimin e saj me një masë më të rëndë ose caktimin e një mase sigurimi shtesë. Për shkeljen e detyrimeve që lidhen me një masë ndaluese, gjykata mund të vendosë zëvendësimin me një masë shtrënguese ose caktimin e një mase shtrënguese shtesë.

3. Në cdo kohë që nevojat e sigurimit zbuten, gjykata, me kërkesë të të pandehurit ose mbrojtësit të tij, mund të vendosë zëvendësimin e masës së sigurimit me një masë më të lehtë.

4. Kërkesa e prokurorit ose e të pandehurit për revokimin, zëvendësimin ose bashkimin e masave të sigurimit shqyrtohet nga gjykata brenda pesë ditëve nga depozitimi i saj.”

Neni 99

Pika 2, e nenit 261, ndryshohet si vijon:

“2. Arresti në burg osë në shtëpi i urdhëruar gjatë hetimeve paraprake humbet fuqinë në qoftë se gjykata nuk procedon në marrjen në pyetje brenda afatit të parashikuar nga neni 248.”

Neni 100

Neni 262 ndryshohet si vijon:

“Neni 262

Pasojat e shuarjes së masave të sigurimit

1. Kur arresti në burg ose në shtëpi e humbet fuqinë, gjykata vendos lirimin e menjëhershëm të personit ndaj të cilit është marrë masa.

2. Në rastet e humbjes së fuqisë së masave të tjera të sigurimit, gjykata vendos heqjen e menjëhershme të tyre.”

Neni 101

Neni 263 ndryshohet si vijon:

Neni 263

Afatet e kohëzgjatjes së arrestit në burg ose në shtëpi

1. Arresti në burg ose në shtëpi e humbet fuqinë në qoftë se nga fillimi i zbatimit të tij kanë kaluar afatet e mëposhtme, pa u dorëzuar aktet në gjykatë:

- a) tre muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimumin deri në dhjetë vjet burgim;
- c) dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

2. Arresti në burg ose në shtëpi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dorëzimit të akteve në gjykatë kanë kaluar afatet e mëposhtme, pa u dhënë vendimi i dënimit në shkallë të parë:

- a) dy muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;
- b) nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në dhjetë vjet burgim;

c) dymbëdhjetë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

3. Arresti në burg ose në shtëpi e humbet fuqinë në qoftë se nga dita e dhënies së vendimit të dënimit në shkallë të parë kanë kaluar afatet e mëposhtme pa u dhënë vendimi i dënimit në gjykatën e apelit:

a) dy muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;

b) gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimumin deri në dhjetë vjet burgim;

c) nëntë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

4. Në rastin kur vendimi priset nga Gjykata e Lartë dhe çështja i dërgohet gjykatës së shkallës së parë ose apelit, si dhe kur vendimi priset nga gjykata e apelit dhe i dërgohet gjykatës së shkallës së parë, nga dita e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë apo të apelit, fillojnë përsëri afatet e parashikuara, për secilën shkallë të procedimit.

5. Në rast ikje të të pandehurit të arrestuar, afatet fillojnë të ecin përsëri nga çasti në të cilin ai arrestohet përsëri.

6. Kohëzgjatja tërësore e arrestit në burg ose në shtëpi, duke marrë parasysh edhe zgjatjen e parashikuar nga neni 264 pika 2, nuk mund të kalojë këto afate:

a) dhjetë muaj, kur procedohet për kundërvajtje penale;

b) dy vjet, kur procedohet për krime që dënohen në minimum deri në dhjetë vjet burgim;

c) tre vjet, kur procedohet për krime që dënohen në maksimum jo më pak se dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

7. Kur në mbarim të afatit të arrestit në burg ose në shtëpi, prokurori i komunikon të pandehurit një akuzë të re, për të cilën parashikohen afate më të gjata arresti në burg osë në shtëpi se ato të akuzës së parë, ai i kërkon gjykatës të caktojë afatin e ri të arrestit. Gjykata vendos në seancë gjyqësore pasi të ketë dëgjuar palët.

8. Kur akuza e re lidhet me një fakt të ri, që nuk dihej në fillim të procedimit, gjykata cakton një afat të ri, i cili fillon të llogaritet nga e para, ndërsa kur ndryshon vetëm cilësimi ligjor i veprës penale, gjykata cakton masën e sigurimit dhe fillimi i llogaritjes së afatit është ai i masës së mëparshme të sigurimit.

9. Afatet e kohëzgjatjes së arrestit në burg ose në shtëpi për të miturit janë sa gjysma e atyre të parashkuara si më sipër për personat madhorë.”

Neni 102

Neni 264 ndryshohet si vijon:

“Neni 264

Zgjatja e afatit të arrestit në burg ose në shtëpi

1. Në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, kur është urdhëruar ekspertimi i gjendjes mendore të të pandehurit, afatet e arrestit në burg ose në shtëpi zgjaten për kohën që është caktuar për kryerjen e ekspertimit. Zgjatja vendoset nga gjykata, mbi kërkesën e prokurorit, pasi dëgjohej mbrojtësi. Kundër vendimit mund të bëhet apel ose rekurs i drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë.

2. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori mund të kërkojë zgjatjen e afateve të arrestit në burg ose në shtëpi, që janë në mbarim e sipër, kur ekzistojnë nevoja të rëndësishme sigurimi dhe verifikimet veçanërisht komplekse e bëjnë të domosdoshme këtë zgjatje. Gjykata pasi dëgjon prokurorin dhe mbrojtësin merr vendim. Zgjatja mund të bëhet vetëm një here dhe nuk mund të jetë më shumë se tre muaj.

3. Kohëzgjatja e qëndrimit në arrest në burg ose në shtëpi nuk mund të kalojë gjysmën e maksimales së dënimit të parashikuar për veprën penale që procedohet.”

Neni 103

Neni 265 ndryshohet si vijon:

“Neni 265

Pezullimi i afateve të arrestit në burg ose në shtëpi

1. Afatet e parashikuara nga neni 263 pezullohen me vendim të ankimueshëm të gjykatës:

- a) për kohën që shqyrtimi gjyqësor është pezulluar ose shtyrë për shkak të veprimeve apo kërkesave të padrejta të bëra nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij, përveç rasteve kur kërkesa bëhet për marrjen e provës;
- b) për kohën që shqyrtimi gjyqësor është pezulluar ose shtyrë për shkak të mosparaqitjes ose të largimit të një a më shumë mbrojtësve, që lënë pa ndihmë një a më shumë të pandehur.”

Neni 104

Neni 266 ndryshohet si vijon:

“Neni 266

Disponimet në rastet e lirimit nga burgu

1. Ndaj të pandehurit të liruar nga burgu për shkak të mbarimit të afateve, gjykata, kur ekzistojnë ende arsyet për të cilat ishte vendosur arresti në burg, cakton masa të tjera sigurimi në qoftë se janë kushtet e kërkuara.

2. Arresti në burg, kur është i nevojshëm, rivihet në fuqi:

- a) kur i pandehuri i ka shkelur me dashje urdhrat e dhëna në lidhje me një masë sigurimi të marrë në bazë të paragrafit 1, por gjithnjë kur ekzistojnë nevojat e sigurimit;
- b) me vendimin e dënimit, kur ekzistojnë nevojat e sigurimit të parashikuara nga neni 228 i këtij Kodi.

3. Me rivënien në fuqi të arrestit në burg, afatet fillojnë të ecin përsëri, por për efekt të llogaritjes së afatit të kohëzgjatjes së përgjithshme të arrestit në burg mbahet parasysh edhe arresti i vuajtur më parë.

4. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore mund të ndalojnë të pandehurin, i cili, duke shkelur urdhrat që lidhen me një masë sigurimi të marrë në bazë të paragrafit 1, ka ikur. Zbatohen, për aq sa pajtohen, dispozitat mbi ndalimin e personit të dyshuar për veprën penale.”

Neni 105

Neni 268 ndryshohet si vijon:

“Neni 268

Kushtet e zbatimit

1. Ai që është deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë ka të drejtën e kompensimit për qëndrimin në arrest në burg, me përjashtim të rasteve kur është provuar që vendimi i gabuar ose moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij.

2. E njëjta e drejtë i takon edhe të dënuarit që ka qëndruar në arrest në burg ose në shtëpi, kur me vendim të formës së prerë vërtetohet se akti me të cilin është caktuar masa është nxjerrë pa qenë kushtet e parashikuara nga nenet 228 dhe 229.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 zbatohen edhe në favor të personit për të cilin është vendosur pushimi i çështjes nga gjykata ose prokurori.

4. Kur me vendim të gjykatës është vërtetuar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, për shkak të shfuqizimit të dispozitës përkatëse, e drejta e kompensimit nuk njihet për atë pjesë të arrestit në burg të vuajtur para shfuqizimit.”

Neni 106

Në nenin 269, në pikën 2, shtohet fjali me përmbajtje si vijon:

“Masa e kompensimit për të miturit do të jetë sa dyfishi i asaj të parashikuar për personat madhorë.”

Neni 107

Në nenin 270, pika 2, ndryshohet si vijon:

“2. Padiësi civil mund të kërkojë sekuestron konservative të pasurisë së të pandehurit ose të të paditurit civil, për të garantuar pagimin e detyrimit civil. Në këtë rast, zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Civile për sigurimin e padisë”.

Neni 108

Neni 279, ndryshohet si vijon:

“Neni 279

Detyrimi për të ruajtur sekretin

1. Veprimet hetimore janë sekrete derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to. Në rast nevojë për vazhdimin e hetimeve, prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit për akte të veçanta deri në përfundim të hetimeve.

2. Prokurori mund të lejojë, me vendim të arsyetuar, publikimin e akteve të veçanta ose të pjesëve të tyre.”

Neni 109

Në paragrafin e tretë të nenit 283, referimi i bërë tek neni 195, ndryshohet me referencën tek neni 194.

Neni 110

Pika 1, e nenit 284, ndryshon si vijon:

“1. Për veprat penale të parashikuara nga nenet 84, 85, 89, 100, 101,102 paragrafi i parë, 105, 106, 130,148, 149, 161, 238, 239, 240, 241, 243, 264, 275, 277, 290, 317 dhe 318 të Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit.”

Neni 111

Neni 288 ndryshohet si vijon:

“Neni 288 Autorizimi

1. Kur për deputetin, Gjyqtarin e Gjykatës kushtetuese, Gjyqtarin e Gjykatës së Lartë apo gjyqtarin parashikohet autorizimi për t’u arrestuar ose për heqjen e lirisë në çfarëdo lloj forme apo që ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, prokurori bën kërkesë në organin përkatës.

2. Kërkesa për autorizim paraqitet nga prokurori kur ekziston një dyshim i arsyeshëm i mbështetur në prova dhe kur plotësohen kushtet ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale për arrestin ose për heqjen e lirisë në çfarëdo lloj forme apo që ndaj subjekteve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni të ushtrohet kontroll personal ose i banesës. Kërkesa për autorizim shoqërohet nga një relacion ku prokurori parashtron provat dhe argumentet ligjore për kërkesën e parashtruar.

3. Kur subjekti i parashikuar në pikën 1 të këtij neni është arrestuar në flagrancë, autorizimi kërkohet menjëherë dhe, sidoqoftë, para seancës së vleftësimit.”

Neni 112

Paragrafi i parë i nenit 289, ndryshohet si më poshtë:

“1. Deri në dhënien e autorizimit, për personat e parashikuar në nenin 288, nuk lejohet arrestimi ose heqja lirisë në çfarëdo lloj forme, apo të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e organit përkatës (të parashikuar me ligj).”

Neni 113

Neni 290 ndryshohet si vijon:

“Neni 290 Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit

1. Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe, në qoftë se ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur:

a) personi ka vdekur;

- b) personi është i papërgjegjshëm ose nuk ka mbushur moshën për përgjegjësi penale;
- c) mungon ankimi i të dëmtuarit ose ai e tërheq ankimin;
- ç) kur fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston;
- d) vepra penale është shuar;
- dh) është dhënë amnisti;
- e) në të gjitha rastet e tjera të parashikuara nga ligji.

2. Kur rezulton një nga rrethanat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, prokurori duhet të shprehet brënda 30 ditëve për rastet kur një procedim nuk mund të fillojë apo duhet të pushohet.”

Neni 114

Neni 292 ndryshohet si vijon:

“Neni 292 Rifillimi i ndjekjes penale

1.Vendimi i mosfillimit të procedimit ose i pushimit, të dhënë për shkak të mungesës së ankimit për procedim ose të kërkesës së autorizimit për procedim, nuk pengojnë ushtrimin e ndjekjes penale për të njëjtin fakt dhe kundër të njëjtit person, në qoftë se më pas bëhet ankimi, jepet autorizimi ose zhduket kushti personal që e bënte të domosdoshëm autorizimin.”

Neni 115

Neni 294/a, ndryshohet si vijon:

“1.Oficeri dhe agjenti i policisë gjyqësore ose personi i autorizuar prej tyre mund të ngarkohen për blerje të simuluar të sendeve, që rrjedhin nga një krim ose simulim i një akti korruptiv, ose të kryejnë veprime të tjera simuluese, për të zbuluar të dhëna financiare, *pasurive ose të hollave të një personi*, për të cilin ka dyshime për kryerjen e një krimi, duke fshehur bashkëpunimin me policinë ose detyrën e tyre si punonjës policie.

2. Këto veprime bëhen me autorizimin e prokurorit që kontrollon hetimet ose të prokurorit që ka në juridiksion territorin ku do të zhvillohet veprimi. Përdorja e pajisjeve të regjistrimit audio-video gjatë veprimit të simuluar duhet të autorizohet nga gjykata, sipas kërkesës së prokurorit. Pas kryerjes së këtyre veprimeve, policia gjyqësore duhet t’i dorëzojë prokurorit të gjitha provat e mbledhura dhe një raport përmbledhës.

3. Nuk duhet provokuar një akt kriminal, duke shtyrë një person të kryejë një krim, të cilin nuk do ta kishte kryer po të mos ishte ndërhyrja e policisë. Kur vërtetohet provokimi, rezultati nuk mund të përdoret.”

Neni 116

Neni 296 ndryshohet si vijon:

“Neni 296 Deklarimet e personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet

1.Oficerët e policisë gjyqësore marrin deklarime nga personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet në praninë e detyrueshme të mbrojtësit të tij. Kur mbrojtësi nuk është gjetur ose nuk është paraqitur, policia gjyqësore kërkon nga prokurori që të caktojë një

mbrojtës tjetër. Ky paragraf nuk zbatohet në rastin e të pandehurit të arrestuar në flagrancë ose të ndaluar.

2. Në vendin e ngjarjes, oficerët e policisë gjyqësore mund të marrin të dhëna të nevojshme për vazhdimin e hetimeve nga i dyshuari për kryerjen e veprës penale, qoftë edhe i arrestuar në flagrancë ose i ndaluar, edhe pa praninë e mbrojtësit të tij. Këto të dhëna nuk fiksohen në proces-verbal dhe nuk mund të përdoren si provë.

3. Personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet mund të paraqitet me vullnetin e tij pranë policisë gjyqësore për të dhënë deklarime. Këto deklarime mund të përdoren në gjykim vetëm për të kundërshtuar përmbajtjen e deklarimeve të bëra para gjykatës.”

Neni 117

Neni 309 ndryshohet si vijon:

“Neni 309

Caktimi dhe ndihma e mbrojtësit

1. I pandehuri që nuk ka mbrojtës njoftohet nga prokurori se ndihmohet nga një mbrojtës i caktuar ex officio.

2. Mbrojtësi i zgjedhur ose i caktuar ex officio lajmërohet të paktën njëzet e katër orë përpara kur procedohet me marrje në pyetje, këqyrje ose ballafaqim. Kur vonesa mund të dëmtojë zhvillimin e hetimeve, lajmërimi i mbrojtësit bëhet urgjentisht.

3. Procesverbalet e veprimeve të kryera nga prokurori dhe nga policia gjyqësore, i vihen në dispozicion mbrojtësit në çdo moment që ai mund t’i kërkojë.”

Neni 118

Neni 316 ndryshohet si vijon:

“Neni 316

Rastet e sigurimit të provës

1. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori dhe i pandehuri mund të kërkojnë nga gjykata që të procedohet me sigurimin e provës në këto raste:

a) në marrjen e dëshmisë së një personi, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ai nuk mund të pyetet në shqyrtimin gjyqësor për shkak sëmundjeje ose pengesë tjetër serioze;

b) në marrjen e dëshmisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se personi mund të jetë objekt dhune, kanosje ose premtimi për t’i dhënë para ose përfitime të tjera me qëllim që të mos bëjë dëshmi ose të bëjë dëshmi të gënjeshtërt;

c) në pyetjen e të pandehurit për faktet që kanë të bëjnë me përgjegjësinë e të tjerëve, kur ekziston një nga rrethanat e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b”;

ç) në ballafaqimin ndërmjet personave që para prokurorit kanë bërë deklarime kundërthënëse, kur ekziston një nga rrethanat e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b”;

d) për një ekspertim apo eksperiment gjyqësor, kur prova ka të bëjë me një person, një send a një vend, gjendja e të cilëve mund të pësojë ndryshime të pashmangshme. Ekspertimi mund të kërkohej edhe kur është rasti që po të bëhet gjatë shqyrtimit gjyqësor do të sillte një pezullim të gjykimit mbi gjashtëdhjetë ditë;

dh) në një paraqitje për njohje, kur për arsye të veçanta nuk mund të shtyhet veprimi deri në shqyrtimin gjyqësor.”

Neni 119

Neni 323 ndryshohet si vijon:

“Neni 323
Afati i hetimeve paraprake

1. Brenda tre muajve nga data në të cilën regjistrimi i procedimit penal është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, prokurori vendos pushimin e procedimit, propozimin e një urdhri penal ose marrëveshjeje për pranimin e fajësisë ose dërgimin e çështjes në gjyq.”

Neni 120

Neni 324 ndryshohet si vijon:

“Neni 324
Zgjatja e afatit

1. Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj.
2. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. Kohëzgjatja e hetimeve paraprake nuk mund të kalojë dy vjet.
3. Tej afatit 2-vjeçar, në raste të jashtëzakonshme, afati i hetimit mund të zgjatet vetëm me miratim të Prokurorit të Përgjithshëm deri në 1 vit, për çdo zgjatje jo më shumë se tre muaj, pa cënuar afatet e kohëzgjatjes së arrestit në burg ose në shtëpi.
3. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet personin nën hetim.
4. Të drejtën për të kërkuar zgjatje të afatit të hetimeve, e gëzon edhe personi nën hetim, kur përcakton qartë provën që kërkon të merret dhe arsyen përse kjo prove nuk është kërkuar brenda afatit.
5. Veprimet hetimore të kryera pas mbarimit të afatit të hetimit nuk mund të përdoren si prova kundër personit nën hetim.”

Neni 121

Neni 325 ndryshohet si vijon:

“Neni 325
Ankimi për zgjatjen e afatit të hetimeve

1. I pandehuri dhe i dëmtuari kanë të drejtë të bëjnë ankim në gjykatën e rrethit kundër vendimit të prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve, brenda dhjetë ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.
2. Ankimi shqyrtohet nga gjykata brenda dhjetë ditëve, duke u dëgjuar i pandehuri, mbrojtësi, viktima dhe prokurori.
3. Kur gjykata pranon ankimin, ajo i cakton prokurorit një afat, brenda të cilit ai duhet të dërgojë çështjen në gjyq ose ta pushojë atë.”

Neni 122

Në nenin 325, shtohet paragrafi i dytë, me përmbajtje si vijon:

“2. Në rastet e vendimit të mosfillimit dhe pushimit, kur konstatohet se kemi shkelje administrative, organi procedues duhet të njoftojë institucionin përkatës për të vlerësuar nëse shkeljet e konstatuara gjatë hetimit ndaj një personi diktojnë marrjen e masave administrative.”

Neni 123

Pas KREUT VIII “PËRFUNDIMI I HETIMEVE”, shtohet Kreu IX “MARRËVESHJET MES PROKURORIT DHE TË PANDEHURIT”, me përmbajtje si vijon:

“KREU IX MARRËVESHJET MES PROKURORIT DHE TË PANDEHURIT

SEKSIONI I MARRËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJËSISË

Neni 332/1 Arritja e marrëveshjes

1. Marrëveshja për pranimin e fajësisë mund të arrihet mes prokurorit dhe të pandehurit që nga momenti i regjistrimit të procedimit deri në momentin kur të pandehurit i kërkohet të deklarohet për akuzën në gjykim.
2. Në momentin e arritjes së marrëveshjes, i pandehuri duhet të ketë mbrojtës.
3. Marrëveshja e bërë më shkrim paraqitet nga prokurori dhe shqyrtohet nga gjyqtari i caktuar sipas nenit 278, nëse bëhet gjatë hetimit paraprak, ose nga kryetari i trupit gjykues, nëse bëhet gjatë gjykimit.
4. Nëse marrëveshja arrihet para se të dërgohet çështja në gjyq, prokurori do t'i bashkangjisë asaj edhe kërkesën për gjykim, e cila përbën një pjesë thelbësore të marrëveshjes.

Neni 332/2 Përmbajtja e marrëveshjes

Marrëveshja përmban:

- a) përshkrimin e veprës penale që përbën objekt akuze;
- b) pohimin e të pandehurit që ai ka kryer veprën penale, së cilës i referohet pika a) e këtij neni;
- c) marrëveshjen në lidhje me llojin dhe minimumin e maksimumin e dënimeve penale kryesore dhe plotësuese;
- ç) marrëveshjen për shpenzimet procedurale, konfiskimin e pasurive për pagimin e gjobës dhe dëmit civil, nëse është paraqitur padi civile dhe, nëse është rasti, marrëveshjen për konfiskimin e produkteve të veprës penale;
- d) deklarin e palëve për heqjen dorë nga drejta e ankimit kundër vendimit të gjykatës, me të cilin pranohet marrëveshja, përveç rastit kur çështja penale duhet të pushohet;
- dh) nënshkrimet e palëve dhe avokatit mbrojtës.

Neni 332/3

Vendimi për marrëveshjen

1. Vendimi mbi marrëveshjen e pranimit të fajësisë merret nga gjyqtari i caktuar sipas nenit 278, nëse bëhet gjatë hetimit paraprak, ose nga kryetari i trupit gjykues, nëse bëhet gjatë gjykimit.

2. Vendimi merret në seancë publike, në të cilën thirren prokurori, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij.

Neni 332/4

Mospranimi i marrëveshjes

1. Gjykata nuk pranon marrëveshjen me vendim të arsyetuar nëse:

- a) marrëveshja nuk përmban elementët e përcaktuar në nenin 332/2;
- b) i pandehuri i njoftuar rregullisht nuk paraqitet në seancë dhe nuk arrin të justifikojë mungesën.

Neni 332/5

Pranimi i marrëveshjes

1. Gjykata pranon marrëveshjen dhe deklaron të pandehurin fajtor me vendim të arsyetuar, nëse çmon se:

- a) i pandehuri ka pohuar kryerjen e veprës ose veprave penale që janë objekt akuze me dijeni dhe vullnet të plotë;
- b) i pandehuri është i ndërgjegjshëm për të gjitha pasojat e marrëveshjes së arritur, vecanërisht heqjen dorë nga e drejta për gjykim dhe kufizimin e të drejtës për të bërë ankim kundër vendimit të dhënë mbi bazën e marrëveshjes;
- c) provat e tjera që janë mbledhur nuk vijnë në kundërshtim me pohimin e të pandehurit se ai e ka kryer veprën penale;
- ç) dënimi kryesor dhe plotësues, për të cilët është rënë dakord nga prokurori dhe i pandehuri janë në përputhje me ligjin penal.

Neni 332/6

Rrëzimi i marrëveshjes

1. Gjykata rrëzon marrëveshjen me vendim të arsyetuar, nëse çmon se:

- a) ekziston një shkak për pushimin e procedimit;
 - b) nuk janë plotësuar një ose më shumë nga kriteret e përcaktuara në nenin 332/5.
2. Kur vendimi i dhënë sipas paragrafit të parë të këtij neni merr formë të prerë, marrëveshja dhe çdo fashikull i krijuar në lidhje me të shkatërrohen në prani të gjyqtarit që ka marrë vendimin, veprimet shënohen në procesverbal dhe procedimi kthehet në fazën, në të cilën ndodhej para se të arrihej marrëveshja.
3. Gjyqtari që ka rrëzuar marrëveshjen nuk mund të marrë më pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Neni 332/7

Ankimi kundër vendimit mbi marrëveshjen

1. Vendimi për mospranimin e marrëveshjes ose rrëzimin e saj nuk është i ankimeshëm.

2. Vendimi për pranimin e marrëveshjes mund të ankimohet nëse ekzistojnë shkaqe për pushimin e procedimit.

SEKSIONI II

MARRËVESHJA PËR DËSHMINË E TË PANDEHURIT

Neni 332/8

Arritja e marrëveshjes

1. Marrëveshja për dëshminë për veprat e krimit të organizuar mund të arrihet mes prokurorit dhe të pandehurit që nga momenti i regjistrimit të veprës penale deri në momentin që i pandehuri deklarohet për akuzën në gjykim.

2. Marrëveshja mund të arrihet me të pandehurin që ka pohuar në mënyrë të plotë se ka kryer një veprë penale, me kusht që rëndësia e dëshmisë së tij në zbulimin, provueshmërinë dhe parandalimin e veprave penale të listuara në paragrafin e parë të këtij neni tejkalon pasojat e veprës penale që ai ka kryer si bashkëpunëtor.

3. Marrëveshja për dëshminë nuk mund t'i propozohet të pandehurit që dyshohet se ka qenë në rolin e organizatorit të një grupi të organizuar kriminal.

4. Në momentin e arritjes së marrëveshjes, i pandehuri duhet të ketë mbrojtës.

5. Marrëveshja për dëshminë bëhet me shkrim dhe i paraqitet gjykatës para se të mbyllet shqyrtimi gjyqësor.

Neni 332/9

Përmbajtja e marrëveshjes

1. Marrëveshja përmban:

a) përshkrimin e veprës penale që përbën objekt akuze;

b) deklarin e të pandehurit se ai pohon në mënyrë të plotë kryerjen e veprës penale, se do të dëshmojë për gjithcka që di në lidhje me veprën penale dhe se nuk do të heqë asgjë nga dëshmia;

c) marrëveshjen në lidhje me llojin dhe minimumin e maksimumin e dënimeve penale kryesore dhe plotësuese;

ç) marrëveshjen për shpenzimet procedurale, konfiskimin e pasurive për pagimin e gjobës dhe dëmit civil, nëse është paraqitur padi civile dhe, nëse është rasti, marrëveshjen për konfiskimin e produkteve të veprës penale;

d) deklarin e palëve për heqjen dorë nga e drejta e ankimit kundër vendimit të gjykatës, me të cilin pranohet marrëveshja, përvec rastit kur çështja penale duhet të pushohet;

dh) nënshkrimet e palëve dhe avokatit mbrojtës.

Neni 332/10

Vendimi për marrëveshjen

1. Vendimi mbi marrëveshjen e pranimit të fajësisë merret nga gjyqtari i caktuar sipas nenit 278, nëse bëhet gjatë hetimit paraprak, ose nga kryetari i trupit gjykues, nëse bëhet gjatë gjykimit.

2. Vendimi merret in camera, në praninë e prokurorit, të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.

Neni 332/11

Pranimi i marrëveshjes

1. Gjykata e pranon marrëveshjen me vendim të arsyetuar, nëse cmon se:
- a) i pandehuri, me dijëni dhe vullnet, pranoi të dëshmonte në kushtet e përcaktuara nga neni 332/8.
 - b) i pandehuri është krejtësisht i ndërgjegjshëm për pasojat e marrëveshjes së arritur dhe, vecanërisht, për heqjen dorë nga e drejta për t'u ankuar kundër vendimit të dhënë nga gjykata mbi bazën e marrëveshjes;
 - c) dënimi penal kryesor ose plotësuar është në përputhje me ligjin penal.

Neni 332/12 **Refuzimi i marrëveshjes**

1. Gjykata rrëzon marrëveshjen me vendim të arsyetuar, nëse cmon se:
- a) ekziston një shkak për pushimin e procedimit;
 - b) nuk janë plotësuar një ose më shumë nga kriteret e përcaktuara në nenin 332/11.
2. Kur vendimi i dhënë sipas paragrafit të parë të këtij neni merr formë të prerë, marrëveshja dhe cdo fashikull i krijuar në lidhje me të shkatërrohen në prani të gjyqtarit që ka marrë vendimin, veprimet shënohen në procesverbal dhe procedimi kthehet në fazën, në të cilën ndodhej para se të arrihej marrëveshja.
3. Gjyqtari që ka rrëzuar marrëveshjen nuk mund të marrë më pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Neni 332/13 **Pyetja e të pandehurit bashkëpunëtor**

1. I pandehuri bashkëpunëtor është i detyruar të tregojë të vërtetën dhe të mos heqë asgjë nga ato që di për objektin e gjykimit.
2. Gjykata mund të vendose që seanca e pyetjes së të pandehurit bashkëpunëtor të bëhet me dyer të mbyllura.

Neni 332/14 **Detyrueshmëria e marrëveshjes**

1. Gjykata e shkallës së parë dhe gjykatat më të larta janë të detyruara të zbatojnë marrëveshjen në marrjen e vendimit për dënimin penal, shpenzimet procedurale, konfiskimin e pasurive për pagimin e gjobës dhe dëmit civil dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale.
2. Gjykata anulon marrëveshjen me vendim të arsyetuar, nëse i pandehuri bashkëpunëtor nuk ka plotësuar detyrimet e marrëveshjes.”

Neni 123

Neni 341 ndryshohet si vijon:

“Neni 341 **Drejtimi i seancës**

1. Drejtimi i seancës bëhet nga kryetari i trupit gjykues. Urdhrat e tij për ruajtjen e rendit e të qetësisë në seancë janë të detyrueshme për palët e pjesëmarrësit dhe të zbatueshme forcërisht.

2. Kryetari i trupit gjykues ka për detyrë të mbrojë dinjitetin dhe sigurinë e gjykatës, të palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në seancë nga fyerjet, kërcënimet ose cdo lloj sulmi tjetër.

3. Të gjithë pjesëmarrësit në seancë janë të detyruar të ngrihen në këmbë kur trupi gjykues hyn dhe del nga salla e gjyqit, si edhe sa herë i drejtohen trupit gjykues, përveçse nëse kjo është e pamundur për arsye objektive.

4. Nëse i pandehuri, mbrojtësi, viktimi, dëshmitari, eksperti apo përkthyesi nuk zbaton urdhrat e gjykatës për ruajtjen e rendit e qetësisë apo fyen dinjitetin e gjykatës, atëherë kryetari i trupit gjykues do ta paralajmërojë atë dhe, nëse ai vazhdon të veprojë si më sipër, do ta dënojë me gjobë deri në 50 000 lekë. Gjoha e caktuar do t'i njoftohet dhomës së avokatëve dhe institucionit, entit apo institutit përkatës për ekspertët dhe përkthyesit, të cilët kanë detyrimin të njoftojnë gjykatën për masat e marra.

5. Nëse prishja e rendit apo qetësisë dhe fyerja e dinjitetit të gjykatës shkaktohen nga prokurori, kryetari i trupit gjykues do ta paralajmërojë atë dhe, në përfundim të seancës, do të njoftojë drejtuesin e prokurorisë. Nëse prokurori vazhdon të shqetësojë rendin e seancës edhe pas paralajmërimit, kryetari i trupit gjykues do të ndërpresë seancën dhe do t'i kërkojë drejtuesit të prokurorisë caktimin e një prokurori tjetër dhe informimin e gjykatës për masat e marra ndaj prokurorit që ka kryer veprimet.

6. Nëse pjesëmarrës të tjerë në seancë nuk zbatojnë urdhrat e gjykatës për ruajtjen e rendit e qetësisë apo fyejnë dinjitetin e gjykatës, kryetari i trupit gjykues i paralajmëron dhe, nëse ata vazhdojnë të veprojnë si më sipër, urdhëron largimin e tyre nga seanca. Nëse ata kundërshtojnë urdhrin për largim nga seanca, kryetari i trupit gjykues i dënon me gjobë deri në 50 000 lekë.

7. Nëse në sallën e gjyqit kryhet një vepër penale që ndiqet ex officio, gjykata informon prokurorinë kompetente.”

Neni 124

Neni 342 ndryshohet si vijon:

“Neni 342 Gjykimi i pandërprerë

1. Kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të përfundohet në një séance të vetme, gjykata vendos që të vazhdojë ditën e mëpasme të punës.

2. Gjykata mund të ndërpresë shqyrtimin gjyqësor, vetëm për arsye të veçanta, deri në *pesë ditë*.

3. Shtyrja dhe ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor shpallen nga kryetari në seancë. Shpallja zëvendëson njoftimin për ata që janë të pranishëm ose që duhet të quhen të pranishëm.

4. Kur për shkaqe të përligjura ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari i ri duhet të njihet me përmbajtjen e procesit gjyqësor, përveç rastit kur kërkohet prej tij që çështja të shqyrtohet nga fillimi. Kur ndryshon më shumë se një nga anëtarët e trupit gjykues që gjykon me tre gjyqtarë dhe më shumë se dy nga anëtarët e trupit gjykues që gjykon me pesë gjyqtarë, gjykimi fillon nga e para.”

Neni 125

Pas nenit 341, shtohet neni 341/1, me përmbajtjen si vijon:

“Neni 341/1

1. Në rast se një avokat apo prokuror nuk është i pranishëm gjatë zhvillimit të procedurave gjyqësor pa ndonjë shkak të arsyeshëm ose pa të drejtë pengon apo vonon procedimin normal të seancave gjyqësore, Gjykata, me kërkesën e palës ose palëve pjesëmarrëse në gjykim, ose me nismën e vet, pas dëgjimit të avokatit ose prokurorit, përcakton nëse ka patur një pengesë për të marrë pjesë, apo mungesa apo vonesa e procedimit normal të Gjykatës ka qënë pa shkaqe të arsyeshme. Në rastin e dytë, kryetari i trupit gjykues mund ta dënojë me gjobë deri në 50 000 lekë. Gjoha përcaktohet në proporcion me dëmin e shkaktuar nga dështimi për të marrë pjesë, nga pengimi i padrejtë, ose vonesa. Në çdo rast, gjoha i njoftohet dhomës së avokatëve.

2. Çdo vendim i tillë përbën titull ekzekutiv. Ndaj çdo vendimi të marrë sipas këtij neni, mund të bëhet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit, me përjashtim të vendimeve të marra nga Gjykata e Lartë. Një ankim i tillë, përveç nëse urdhërohet ndryshe nga Gjykata e Apelit, nuk do të veprojë si një shtyrje e ekzekutimit të vendimit.”

Neni 126

Neni 344 ndryshohet si vijon:

“Neni 344

Prania e të pandehurit në seancë

1. I pandehuri merr pjesë në seancë si person i lirë edhe kur është i arrestuar, me përjashtim të rasteve kur duhen marrë masa të domosdoshme për të parandaluar rrezikun e ikjes a të dhunës.

2. Nëse masat e marra sipas nenit 341 të këtij Kodi nuk japin rezultat, trupi gjykues mund të urdhërojë largimin e të pandehurit nga salla për një kohë të caktuar. Nëse, edhe pas kalimit të kësaj kohe dhe kthimit në sallë, i pandehuri vazhdon të shqetësojë rendin në seancë, gjykata mund ta urdhërojë që ai të largohet nga seanca deri në shpalljen e vendimit përfundimtar.

3. Nëse është e mundur, i pandehuri i larguar sipas paragrafit 2 të këtij neni e ndjek seancën nëpërmjet lidhjes audio dhe/ose video.

4. Nëse i pandehuri i larguar sipas paragrafit 2 të këtij neni ka zgjedhur të mbrohet vetë, gjykata i cakton një mbrojtës ex officio që do ta përfaqësojë gjatë kohës që ai nuk merr pjesë në seancë.”

Neni 127

Neni 345 ndryshohet si vijon:

“Neni 345

Procesverbali i seancës

1. Sekretari bën regjistrimin audio të seancës gjyqësore sipas parashikimeve të nenit 115.

2. Përpos rregjistrimit audio sekretari gjyqësor mban me dorështrim apo shtypshtrim, procesverbalin e seancës në të cilin pasqyrohen:

- a) vendi, data, ora e hapjes dhe e mbylljes së seancës;
- b) përbërja e gjykatës;
- c) emri dhe mbiemri i prokurorit dhe të dëmtuarit akuzues;

ç) gjeneralitetet e të pandehurit ose të dhëna të tjera personale që vlejné për ta identifikuar, gjeneralitetet e mbrojtësve, të palëve private dhe të përfaqësuesve të tyre.

d) të dhënat e mbrojtësit dhe shkeljet e bëra në seancën gjyqësore.

3. Procesverbali i mbajtur me dorëshkrim apo shtypshkrim nënshkruhet nga sekretari gjyqësor dhe nga kryetari i trupit gjykues.

4. Procesverbali, materiali i regjistrimit dhe transkripti i tij, nëse është bërë, bashkohen me dosjen gjyqësore.”

Neni 128

Neni 352, ndryshohet si vijon:

“Neni 352

Mungesa dhe largimi i vullnetshëm i të pandehurit

1. Kur i pandehuri kërkon ose jep pëlqimin që shqyrtimi gjyqësor të bëhet në mungesë të tij, ose duke qenë i burgosur, refuzon të marrë pjesë pa shkak të arsyeshëm, gjykata deklaron mungesën e vullnetshme të tij dhe gjykimi vazhdon në prezencë të mbrojtësit të zgjedhur.

2. Në qoftë se mbrojtësi i zgjedhur prej të pandehurit nuk është paraqitur pa shkaqe të arsyeshme, gjykata cakton mbrojtës kryesisht dhe gjykimi vazhdon në të njëjtën ditë.

3. Gjykimi në mungesë mund të bëhet edhe kur i pandehuri, megjithë kërkimet e bëra, nuk gjendet në vendbanimin zyrtar ose atë të deklaruar prej tij ose provohet se i fshihet drejtësisë.

4. Kur i pandehuri, pasi është paraqitur, largohet vetë nga salla, apo për sjellje të parregullt urdhërohet largimi i tij, gjykimi zhvillohet në mungesë. Interesat e tij përfaqësohen nga mbrojtësi, vazhdimi i pjesëmarrjes së të cilit është i detyrueshëm, sipas parashikimit të nenit 344 të këtij Kodi. Dispozitat e paragrafit të dytë të këtij neni zbatohen edhe kur i pandehuri i paraburgosur ikën në cdo moment të shqyrtimit gjyqësor ose gjatë intervaleve të tij.”

Neni 129

Pas nenit 353 shtohet neni 353/a me këtë përmbajtje:

“Neni 353/a

Shpallja e trupit gjykues

Gjykata shpall përbërjen e saj, duke deklaruar emrat e anëtarëve të trupit gjykues dhe pyet palët nëse kanë ndonjë shkak për të kërkuar përjashtimin e ndonjërit prej anëtarëve.”

Neni 130

Neni 361 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 361

Pyetja e dëshmitarëve

1. Pyetja e dëshmitarëve bëhet fillimisht nga pala që ka kërkuar marrjen e dëshmisë (pyetja e drejtpërdrejtë). Gjatë pyetjes nga kjo palë nuk lejohen pyetjet drejtuese.

2. Më pas, dëshmitari pyetet nga pala tjetër (pyetja e tërthortë). Pala që ka kërkuar marrjen e dëshmisë mund të bëjë pyetje edhe pasi mbaron pala tjetër.

3. Për të ndihmuar kujtesën, dëshmitari mund të lejohet të shikojë dokumentet e hartuar prej tij.

4. Dëshmitarit nuk mund t'i bëhen pyetje që mund të ndikojnë në paanësinë e tij (pyetje argumentuese).

5. Gjatë pyetjes së dëshmitarit, kryetari i trupit gjykues ndërhyr për të siguruar radhën e pyetjeve, për të zgjidhur kundërshtimet e palëve dhe për të garantuar respektimin e dinjitetit të personit.

6. Dëshmitari mund të pyetet në distancë, brenda ose jashtë vendit, me anë të lidhjes audiovizive, duke respektuar rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitat e këtij Kodi. Personi i autorizuar nga gjykata qëndron në vendin ku ndodhet dëshmitari dhe bën vërtetimin e identitetit të tij, si dhe kujdeset për zhvillimin e rregullt të marrjes në pyetje e për zbatimin e masave të mbrojtjes. Këto veprime ai i pasqyron në procesverbal.”

Neni 130

Pas nenit 361, shtohen nenet 361/a dhe 361/b, me këtë përmbajtje:

“Neni 361/a

Pyetja e dëshmitarëve të dobët

1. Pyetja e dëshmitarit të dobët bëhet vetëm nga gjykata, e cila e trajton dëshmitarin me kujdes të vecantë, duke u munduar të shmangë pasojat negative që mund t'i shkaktohen dëshmitarit në personalitetin, gjendjen fizike ose mendore të tij.

2. Pyetja e dëshmitarit të dobët mund të kryhet me ndihmën e një psikologu, punonjësi social apo specialisti tjetër, sipas vendimit të gjykatës. Në rastin kur dëshmitari i dobët është i mitur, kjo ndihmë është e detyrueshme.

3. Dëshmitari i dobët mund të pyetet edhe në banesën e tij, në ambiente të tjera ose në një institucion të autorizuar, të kualifikuar profesionalisht për të kryer pyetjen e dëshmitarëve të dobët. Në këto raste, pyetja e dëshmitarit kryhet pa praninë e palëve dhe transmetohet nëpërmjet pajisjeve që transmetojnë zërin dhe figurën.

4. Dëshmitari i dobët nuk mund të ballafaqohet me të pandehurin, përveç nëse e kërkon vetë.

Neni 361/b

Pyetja e dëshmitarëve të mbrojtur

1. Para pyetjes së dëshmitarit të mbrojtur, gjykata paralajmëron të gjithë të pranishmit se kanë detyrimin të ruajnë sekretin e të dhënave mbi dëshmitarin e mbrojtur, të afërmit e tij dhe rrethana të tjera që mund të cojnë në zbulimin e identitetit të tyre dhe se zbulimi i këtyre të dhënave sekrete përbën vepër penale. Paralajmërimi dhe emrat e personave të pranishëm shënohen në procesverbal.

2. Gjkata nuk do të lejojë që dëshmitarit të mbrojtur t'i bëhen pyetje që mund të zbulojnë identitetin e tij.”

Neni 131

Në nenin 362, paragrafi i parë ndryshohet si vijon:

“1. Për të kundërshtuar, tërësisht ose pjesërisht, përmbajtjen e dëshmisë së dhënë, palët mund të përdorin deklaratimet e mëparshme të ndryshme të dëshmitarit para prokurorit ose policisë gjyqësore. Pala që ka kërkuar thirrjen e dëshmitarit ka të drejtë të bëjë pyetje shtesë pas kundërshtimit të dëshmisë (rehabilitimi).

Deklarimet e mëparshme të përdorura për kundërshtimin e dëshmisë futen në fashikullin e gjykatës.”

Neni 132

Në paragrafin e dytë të nenit 381, togfjalëshi “dhe ndihmësgjyqtarët” hiqet.

Neni 133

Neni 403 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 403 Kërkesa për gjykimin e shkurtuar

1. Kërkesën për gjykim të shkurtuar e paraqet i pandehuri ose mbrojtësi i tij, të cilit i është dhënë kjo e drejtë në mënyrë të shprehur në prokurë.
2. Kërkesa paraqitet në afatet e përcaktuara në nenet 335 dhe 354 të këtij Kodi.
3. Kërkesa bëhet me shkrim, kurse në seancë formulohet me gojë.”

Neni 134

Neni 404 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 404 Disponimet e gjykatës për kërkesën

1. Gjykata i kërkon paditësit civil të deklarojë nëse është dakord me zhvillimin e gjykimit të shkurtuar. Nëse paditësi civil nuk është dakord, padia civile nuk shqyrtohet.
2. Kur gjykata çmon se çështja mund të zgjidhet në gjendjen që janë aktet, vendos gjykimin e shkurtuar dhe cakton seancën e këtij gjykimi. Nëse kërkesa bëhet në seancë gjyqësore, gjykimi i shkurtuar zhvillohet në të njëjtën seancë.”

Neni 135

Neni 405 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Neni 405 Seanca e gjykimit të shkurtuar

1. Seanca fillon me parashtrimin e përmbledhur të rezultateve të hetimeve paraprake dhe vazhdon me procedurën e marrjes së provave.
2. Nëse palët kërkojnë marrjen e provave të reja ose pretendojnë pavlefshmërinë e akteve a papërdorshmërinë e provave, gjykata revokon vendimin për pranimin e gjykimit të shkurtuar dhe procedon me gjykim të zakonshëm.

3. Pas marrjes së provave, palët parashetrojnë konkluzionet e tyre përfundimtare.”

Neni 136

Në nenin 407, paragrafi i parë dhe i dytë, ndryshojnë si vijon :

“1. Ligji cakton rastet në të cilat vendimet e gjykatës mund të ankimohen, si dhe mjetin e ankimit.

2. Ankimi i vendimit të gjykatës, kur nuk parashikohet ndryshe nga ligji, mund të bëhet vetëm me ankimin kundër vendimit”.

Neni 137

Neni 408 ndryshohet si vijon:

“Neni 408 Ankimi i prokurorit

1. Prokurori i seancës mund të bëjë ankim kundër vendimit të gjykatës në rastet e caktuara nga ligji.

2. Kur prokurori i seancës nuk bën ankim, e drejta e ankimit mund të ushtrohet nga prokurori më i lartë.

3. Prokurori i seancës mund të përfaqësojë ankimin në gjykatën e apelit, me autorizim të prokurorit të apelit.”

Neni 138

Në nenin 410, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

“2. Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar personalisht nga i pandehuri.”

Neni 139

Neni 415, ndryshohet si vijon:

“Neni 415 Afatet e ankimit

1. Afati për të bërë ankim është:

- a) dhjetë ditë për ankimin pranë Gjykatës së Apelit;
- b) tridhjetë ditë për ankimin pranë Gjykatës së Lartë;

Ky afat fillon nga data që palët njoftohen për arsyetimin e vendimit.

2. Ai që ka bërë ankim ka të drejtë që deri pesë ditë para seancës të paraqesë në sekretarinë e gjykatës që do të shqyrtojë çështjen, arsye të tjera që lidhen me ankimin.

3. Afatet e parashikuara nga ky nen nuk mund të zgjaten për asnjë shkak, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

4. Ankimi kundër vendimit nuk pezullon gjykimin e çështjes në themel.”

Neni 140

Në nenin 417, paragrafi i parë, ndryshohet si vijon:

“1. Ekzekutimi i vendimit të ankimuar pezullohet deri në përfundimin e gjykimit në gjykatën e apelit.”

Neni 141

Në nenin 421, shtohet paragrafi i katërt, me këtë përmbajtje:

“4. Nëse rekursi është deklaruar i papranueshëm apo rrëzohet, pala private, përveç shpenzimeve gjyqësore, dënohet gjithashtu me të njëjtin vendim, për pagimin në formë gjobe të një shume të hollash prej 100 000 lekësh.”

Neni 142

Në nenin 432 bëhen ndryshimet si vijon:

a) Shkronja a) e paragrafit të parë, ndryshohet si vijon:

“a) për interpretim të gabuar të ligjit penal;

b) Shkronja c) e paragrafit të parë të këtij neni shfuqizohet.

Neni 143

Pas nenit 432, shtohet neni 432/1 me përmbajtjen si vijon:

“Neni 432/1

Mund të ankimohen me rekurs në Gjykatën e Lartë të gjitha vendimet e dhëna nga gjykata e apelit, me përjashtim të:

a) Vendimeve të pezullimit dhe shtyrjes së ekzekutimit të vendimit, sipas nenit 59 të Kodit penal dhe nenit 476 të këtij kodi.

b) Vendimeve me të cilët është vendosur prishje vendimi dhe pushimi i içështjes, kur janë rastet që nuk lejojnë fillimin ose vazhdimin e procedimit ose kur nuk vëretetohet fajësia e të pandehurit sipas nenit 428, shkronja “c”.

c) Vendimeve me të cilët është vendosur prishje vendimi dhe kthimi i akteve sipas nenit 428, shkronja “ç”.

d) Vendimet e marra lidhur me masat shtrënguese të sigurimit personal, sipas neneve 249/8 dhe 249/10 të këtij kodi.

e) Vendimeve lidhur me lirimi me kusht sipas nenit 64 të Kodit Penal dhe nenit 477 të këtij kodi.

f) Vendime që kanë të bëjnë me zëvendësimin e dënimit me burgim me masa të tjera gjatë vuajtjes së dënimit, të parashikuara sipas neneve 58 deri në 65/a të Kodit Penal.

g) Vendimeve që kundërshtohen gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale të formës së prerë, sipas parashikimeve të bëra në nenin 470 e vijues të këtij kodi.

h) Vendimeve të pushimit të çështjes penale sipas nenit 385 të këtij kodi.

- i) Vendimeve që kanë të bëjnë me sekuestron konservative dhe atë preventive të parashikuara nga nenet 270 deri në 276 të këtij kodi.
- j) Vendimeve të marr lidhur me zgjatjen e afatit të hetimeve paraprake, sipas nenit 325 të këtij kodi.
- k) Vendimeve të marra mbi kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit sipas nenit 22/4 të këtij kodi.”

Neni 144

Paragrafi 2 i nenit 433 ndryshohet si vijon:

“2. Mospranimi i rekursit vendoset nga trupi gjykues i përbërë nga 5 gjyqtarë në prani të prokurorit, të pandehurit dhe avokatit të tij, pa pjesëmarrjen e palëve.”

Neni 145

Paragrafi i dytë, i nenit 435, ndryshohet si vijon:

“2. Akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, nga mbrojtësit. Kolegji që shqyrton rekursin ka detyrimin të njoftojë të pandehurin kur rekursi i paraqitur nga prokurori mund të rëndojë pozitën e tij. Kur i pandehuri nuk ka mbrojtës të zgjedhur, ose ai dhe mbrojtësi i tij nuk paraqiten në gjykatë kryetari i kolegjit cakton një mbrojtës *ex officio* dhe njofton të pandehurin.”

Neni 146

Në fund të nenit 450, shtohet shkronja d) me përmbajtje si vijon:

“d) kur Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ose të Protokolleve të saj.”

Neni 147

Në nenin 467, paragrafi i dytë, shfuqizohet.

Neni 148

Neni 470 ndryshohet si vijon:

“Neni 470

Gjykata kompetente për ekzekutimin

1. Gjykata e vendit ku është ekzekutuar vendimi është kompetente për shqyrtimin e kërkesave dhe pretendimeve që lidhen me ekzekutimin e tij, me përjashtim të rastit kur vendimi ekzekutohet në një shtet të huaj. Në këtë rast, është kompetente gjykata që ka dhënë vendimin.

2. Kur ekzekutimi bëhet në një shtet të huaj dhe ka të bëjë me disa vendime të dhëna nga gjykata të ndryshme shqiptare, kompetente është gjykata që ka dhënë vendimin, i cili ka marrë formë të prerë i fundit.”

Neni 149

Në nenin 478, fjalët “kur vazhdimi i burgimit mund të rrezikojë jetën e tij” zëvendësohen me fjalët “në rastet e sëmundjeve të rrezikshme për jetën të cilat kërkojnë trajtim të veçantë mjekësor.”

Neni 150

Në nenin 490, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) Në paragrafin 2, gërma b, togfjalëshi “dyzet e pesë” zëvendësohen me fjalën “tridhjetë”;
- b) Në fund të paragrafit 3, shtohet togfjalëshi “pa tejkalluar parashikimet e akteve ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë”.

Neni 151

Në nenin 493, në fund të paragrafit të pestë, shtohet fjalia “Gjyqtari që ka urdhëruar masën e sigurimit duhet të jetë i ndryshëm nga ai që shqyrton kërkesën për njohjen e vendimeve penale të huaja ose kërkesën për ekstradim”.

Neni 152

Në nenin 494, fjalët “tetëmbëdhjetë ditëve dhe gjithësesi në maksimum dyzet ditë” zëvendësohen me fjalët “3 muajve”.

Neni 153

Në paragrafin 3 të nenit 495, fjala “arrestimi” zëvendësohet me fjalët “momenti i paraqitjes përpara gjykatës së kërkesës të prokurorit për vlerësimin e arrestimit”.

Neni 154

Neni 506 shfuqizohet.

Neni 155

Në nenin 507 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- a) Në nenin 507, paragrafi 1 ndryshohet si vijon:

“1. Ministria e Drejtësisë, pas dhënies rrugë, ia përcjell aktet prokurorit të rrethit ku duhet të ekzekutohet letërporosia, nëpërmjet Prokurorit të Përgjithshëm, brenda 10 ditëve nga marrja e akteve. Në raste urgjente, Ministria e Drejtësisë mund t’ia përcjellë aktet prokurorit të rrethit, duke njoftuar njëkohësisht Prokurorin e Përgjithshëm. Prokurori pasi merr aktet ekzekuton drejtpërdrejt letërporosinë.”

b) Pas paragrafit 2 shtohet paragrafi 3 me përmbajtje si vijon:

“3. Ekzekutimi i letërporosisë nuk pranohet:

- a) kur janë rastet që Ministria e Drejtësisë, pa tejkalar parashikimet e akteve ndërkombëtare në të cilat Republika e Shqipërisë është palë, nuk i jep rrugë letërporosisë;
- b) kur objekt i saj është kërkimi dhe sekuestrimi i pasurisë dhe vepra për të cilin procedon autoriteti i huaj nuk parashikohet nga ligji shqiptar si vepër penale.”

Neni 156

Neni 512 ndryshohet si vijon:

“Neni 512

Njohja e vendimeve penale të huaja

1. Ministria e Drejtësisë, kur i vjen një vendim penal i dhënë jashtë shtetit ndaj shtetasve shqiptarë ose të huaj ose pa shtetësi, por me banim në shtetin shqiptar, ose ndaj personave të proceduar penalisht në shtetin shqiptar, pasi vlerëson se nuk ka pengesa për njohjen e një vendimit penal të huaj në përputhje me rregullat e këtij kodi, i dërgon prokurorit pranë gjykatës së rrethit gjyqësor të vendbanimit ose vendqëndrimit të personit, një kopje të vendimit dhe dokumentacionin përkatës, bashkë me përkthimin në gjuhën shqipe, me qëllim që ky i fundit të kërkojë nga gjykata kompetente njohjen e këtij vendimi

2. Ministria e Drejtësisë kërkon, nëpërmjet prokurorit, njohjen e një vendimi penal të huaj nga gjykata kompetente shqiptare, edhe kur çmon se në bazë të një marrëveshje ndërkombëtare ky vendim duhet të ekzekutohet ose t’i njihen efekte të tjera në shtetin shqiptar.

3. Prokurori i bën kërkesë gjykatës së rrethit gjyqësor për njohjen e vendimit të huaj. Nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë ai mund t’u kërkojë autoriteteve të huaja informacionet që i çmon të nevojshme.

4. Në rast ankimi kundër vendimit të dhënë në mungesë, personi i dënuar ka të drejtë të zgjedhë mes shtetit që e ka dënuar dhe shtetit ku do të njihet vendimi. Nëse personi i dënuar nuk shpreh zgjedhjen e tij, ankimi shqyrtohet nga gjykata kompetente në shtetin ku do të njihet vendimi. Në rastet e specifikuara më sipër ankimi bëhet pranë gjykatës kompetente brenda 30 ditësh nga data e dhënies së njoftimit. Gjkata njofton menjëherë Ministrinë e Drejtësisë dhe Prokurorinë që ka bërë kërkesën.”

Neni 157

Dispozitë kalimtare

Çështjet penale, që janë në gjykim ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë të gjykohen në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe në Gjykatën e Apelit sipas ligjit të kohës së paraqitjes së kërkesës.

Neni 158
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

ILIR META